

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5579
E martë, 18 shtator 2018
çmimi 0.40 €

Papa Françesku e pret në takim Metën, flasin edhe për Kosovën



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE" KRYETARI I OVLUÇK-SË, HYSNI GUCATI

Prokuroria na ka futur në qorrrokak

- Prokuroria i ka pështjellë punët. Ajo duhet t'u kërkojë falje personave që ka fyer, duke i bërë veteranë të rremë dhe duke ua përlyer sakrificën për çlirimin e vendit



Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hysni Gucati, ka shprehur pakënaqësi ndaj prokurorisë për përfshirjen e veteranëve të vërtetë në listën e "veteranëve të rrejshëm". Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se

Prokuroria e Kosovës të gjithë procesin e ka shpënë në një qorrrokak. "Mendoj se në këtë rast është ngutur prokuroria që ka lejuar të bëhen listat publike duke e shkelur privatësinë e këtyre personave. Ndiem i zhgënjyer nga prokuroria se si ka arritur të bëjë gabime të tilla", ka

thënë Gucati. Ai ka treguar se ditën e hënë janë ankuar mbi një mijë veteranë të vërtetë në degët e OVLUÇK-së në gjithë Kosovën. Gucati ka theksuar se nuk është ihtar i protestave, por i ka bërë thirrje Qeverisë ta fillojë rivlerësimin e gjithë këtij procesi

Rinovohet Klinika Emergjente, pajiset me aparaturën më moderne

Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka bërë me dije se janë investuar rreth gjysmë milion euro për transformimin e Klinikës Emergjente në një klinikë moderne dhe të pajisur me aparaturë të teknologjisë së fundit. Ai ka thënë se ky renovim nënkupton siguri më të madhe për pacientët dhe personelin mjekësor. Të pranishëm në përrurimin e kësaj klinike kanë qenë edhe kryeparlamentari Veseli dhe kryeministri Haradinaj të cilët kanë premtuar kushte më të mira infrastrukturore në shëndetësi dhe shërbime më cilësore për pacientë



Qeveria thotë se Asociacioni s'do të ketë karakter ekzekutiv dhe territorial

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

AKTUALE

A NA DUHET VËRTET VERIU I KOSOVËS? F.13

Mimoza KERMENDI



AKSIONI 'TA PASTROJMË KOSOVËN' BËRI BASHKË MË SHUMË SE 109 MIJË VULLNETARË F.6

PËRFAQËSUESIT E SBASHK-UT KËRKOJNË QË SEKTORIT TË ARSIMIT T'I RRRITET KOEFICIENTI I PAGËS F.6

TONINO PICULA KONFIRMON PËRKRAHJEN PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE F.5

EKONOMI

RIKTHEHET TAKSA NË RRUGËN E KOMBIT F.8

PAPUNËSIA NË TREMUJORIN E DYTË, AFËR 30 PËR QIND F.9

KULTURË

ALEKSANDËR MOISIU, FANTAZMA E SHEKULLIT XX F.13



RÜDIGER SCHAPER

SPORT

DRITA SHEH SHPËTIMIN TE SHPËTIM DURO F.16

LIGA E KAMPIONËVE RIKTHEHET ME DY SUPERPËRBALLJE F.16

A na duhet vërtet veriu i Kosovës?



Mimoza KELMENDI

Për të qenë të sinqertë, kush ka ndjekur nga afër zhvillimet qysh në Konferencën e Rambujesë apo të Parisit dhe më pas Planin Ahtisari me implementimin i tij, apo shpalljen e Pavarësisë së Kosovës (shkurt 2008), e ka kuptuar se me veriuin diçka nuk shkon. Në vitin 1999, ndërkombëtarët, duke vënë kufirin mbi lumin Ibër, praktikisht ndan edhe qytetin e Mitrovicës, duke e

lënë pjesën veriore të qytetit në duar të Ushtrisë dhe Policisë jugosllave. Shkurt dhe troç: Një skenar i turbullt me prapavijë nga ndërkombëtarët ishte sajuar. Por, siç thotë populli: një sy qorr dhe një vesh të shurdhër, u pranua edhe nga shqiptarët. Pikërisht ky skenar tashmë duket se po vë në lëvizje "regjisorë dhe aktorë" kudo për t'i dhënë fund ngërçit që veç armiqësisë, asnjë perspektive tjetër nuk ofroi.

Si për Prishtinën, ashtu edhe për Beogradin.

Tani, shtator 2018, shtrohet pyetja: A është premtimi i anëtarësisë aq i fortë sa që të gjitha palët të ulen dhe të thonë: Mirë ne jemi në prag të anëtarësimit në Bashkimin Evropian apo OKB. A jemi gati t'i sakrifikojmë disa nga parimet të cilave u jemi

përmbajtur deri tani për arsye të besimit, për arsye politike, ideologjike dhe për arsye strategjike. A jemi gati të sakrifikojmë, të heqim dorë nga pretendimet, kërkesat tona, sepse këtu është rreziku edhe i ruajtjes së prestigjit në këtë proces. Për shembull të dilte presidenti i Serbisë dhe të thoshte: Po, do ta njohim Kosovën si shtet. Ose presidenti i Kosovës të thotë: A është vërtet e nevojshme pjesa veriore për ne? Nuk them që kjo duhet të jetë zgjidhja dhe nuk them që është kjo e vetmja zgjidhje, por dua të them që duhet të ketë një nivel shumë të lartë të pragmatizmit në negociata që të arrihet një mirëkuptim për zgjidhje.

Nëse Serbia është vërtet gati për një hap të tillë, për një njohje ndërkombëtare, për një përcak-

tim kufijsh me Kosovën dhe vetë Kosova është gati për të rënë dakord për një përcaktim kufijsh të rinj apo ndryshim ose korigjim kufijsh me Serbinë, askush nga Bashkimi Evropian ose nga bashkësia ndërkombëtare nuk do të thotë jo. Sepse nëse bëhet në mënyrë paqësore përmes negociatave dhe nëse procesin e mbështesin shumicat e popullsisë, që do të thotë nëse Parlamenti i Kosovës dhe Parlamenti i Serbisë bien dakord për një marrëveshje të tillë, unë mendoj që ky do të ishte një hap i dy shteteve sovraane, që e njohin njëri-tjetrin. Kjo do të ishte legalisht e mundshme, por unë nuk jam e sigurt nëse politika është e gatshme për këtë, pra politika e Kosovës dhe ajo e Serbisë.

Këtë e tregoi edhe vizita e Vuçiqit

në Kosovë, apo mungesa e një qëndrimi unik të liderëve në Prishtinë.

Në thelb dy shtetet sovraane kanë të drejtë të negociojnë edhe për kufijtë midis tyre. Problemi është a ka një besueshmëri mes dy palëve apo jo, pra duhet të zhvillohen negociata serioze me këtë frymë besueshmërie për të arritur në një zgjidhje. Edhe Kosova vetë duke pranuar që ka një minoritet në veri, por që është armiqësuar me të gjithë Kosovën, mund të arrijë edhe në një pozitë që duhet të shtrojë pyetjen nëse i duhet ky minoritet? Natyrisht që kjo çështje është shtruar në tryezën e bisedimeve, por kam drojë se një marrëveshje "historike paqësore" në mes të Prishtinës dhe Beogradit mund të përfundojë edhe në qorrsoak.

Papa Françesku e pret në takim Metën, flasin edhe për Kosovën

VATIKAN, 17 SHTATOR (ER) - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, është prituri të hënën në një audiencë të posaçme nga Ati i Shenjtë, Papa Françesku, në Selinë e Shenjtë në Vatikan. Presidenti Meta ka shprehur mirënjohjen e thellë për kontributin e jashtëzakonshëm të Selisë së Shenjtë në rimëkëmbjen shpirtërore e sociale të komunitetit katolik dhe popullit shqiptar, veçanërisht pas daljes së vendit nga izolimi i gjatë komunist dhe vendosjes së pluralizmit në Shqipëri.

Në mënyrë të veçantë presidenti Meta e ka falënderuar Papa Françeskun për lartësimin mbarëbotëror të simbolit më domethënës shpirtëror të kombit shqiptar, Nënë Terezës, përmes shenjtërimit të saj. Duke shprehur mirënjohjen për vëmendjen e veçantë që Papa Françesku ka treguar për popullin shqiptar, presidenti Meta e siguroi Atin e Shenjtë për vokacionin e qartë e të pandryshuar evropian të Shqipërisë dhe shqiptarëve dhe vendosmërinë e tyre për të ecur në rrugën e integritimit evropi-



an. Të dy bashkëbiseduesit vlerësuan rëndësinë e jashtëzakonshme që merr në ditët e sotme modeli shqiptar i harmonisë ndërmjet bashkësive të ndryshme fetare si dhe ranë dakord për ta vijuar bashkëpunimin e ngushtë në

mes të Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për promovimin e mëtejshëm të kësaj vlere në mbarë botën.

Një mirënjohje të veçantë presidenti Meta e shprehu edhe për mbështetjen e vyer që Papa Françesku dhe Selia e Shenjtë i kanë dhënë Kosovës dhe që, pa

dyshim, lartësimi në ditën e Shën Terezës së Kishës Katolike të Prizrenit në Dioqezë përbën një akt domethënës jo vetëm për komunitetin katolik të Kosovës, por për mbarë shqiptarët.

Presidenti Meta dhe Ati i Shenjtë diskutuan edhe për

zhvillimet e fundit në rajonin e Ballkanit dhe për rëndësinë e jashtëzakonshme që ka bashkëjetesa ndëretnike dhe fetare në dobi të stabilitetit, sigurisë, paqes dhe mirëqenies së popujve tanë për të mos u rikthyer më kurrë në konfliktet e përgjakshme në vitet '90.

Qeveria thotë se Asociacioni s'do të ketë karakter ekzekutiv dhe territorial

"Do të bëjmë çdo gjë që Asociacioni për Komunat me Shumicë Serbe të mos ketë kompetenca ekzekutive, të mos ketë karakter ekzekutiv dhe territorial" ka deklaruar për gazetën "Epoka e re" zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj. Ai ka theksuar se rreziku më i madh që mund ta ketë Kosova në procesin e dialogut është themelimi i këtij asociacioni. Ndërkaq njohësi i proceseve politike, Behxhet Shala, ka thënë se nëpërmjet këtij asociacioni Serbia ka për synim autonominë politike, ekonomike dhe territoriale për serbët e Kosovës



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka bërë me dije se rreziku më i madh që mund ta ketë Kosova në procesin e dialogut është themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Ai ka thënë se do të bëjnë çdo gjë që ky Asociacion të mos ketë karakter ekzekutiv dhe territorial. Madje Hoxhaj ka thënë për gazetën "Epoka e re" se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe do të duhej të themelohej në atë çast kur Kosova të anëtarësohet në OKB. Sipas tij, pa e marrë një qartësi të anëtarësimit tonë në OKB nuk ka nevojë të mendohet as koha e themelimit të këtij asociacioni. "Qëndrimi ynë është ky: Do të bëjmë çdo gjë që Asociacioni për Komunat me Shumicë Serbe të mos ketë kompetenca ekzekutive, të mos ketë karakter ekzekutiv dhe territorial. Dhe rreziku më i madh që mund ta ketë Kosova në procesin e dialogut është pikërisht themelimi i këtij asociacioni. E kam thënë disa herë deri më tash, se asociacioni,

në bazë të rekomandimeve që i ka dhënë Gjykata Kushtetuese, do të duhej të themelohej në atë çast kur Kosova të anëtarësohet në OKB. Pa e marrë një qartësi të anëtarësimit tonë në OKB nuk ka nevojë të mendohet as koha e themelimit të këtij asociacioni. Jemi të interesuar që kjo të shihet në kuadër të arritjes së një marrëveshje obligative ligjore në mes të dy vendeve", ka deklaruar Hoxhaj.

Për çështjen e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe ka folur ditë më parë edhe lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa. Sipas tij, marrëveshja e parë e nënshkruar nga Thaçi dhe as dokumenti i parimeve i nënshkruar nga Mustafa nuk i japin Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe kompetenca ekzekutive dhe të pushtetit të tretë. "E kam sqaruar se Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe iu kanë vënë themelet me marrëveshjen e parë të nënshkruara nga z. Thaçi atëherë kryeministër dhe e ratifikuar me mbi 2/3 nga Kuvendi i Kosovës. Për të qenë korrekt, duhet të shtoj se as marrëveshja e

parë e nënshkruar nga Thaçi dhe as dokumenti i parimeve i nënshkruar nga unë nuk i japin Asociacionit kompetenca ekzekutive dhe të pushtetit të tretë. Deklaratat për këtë po jepen nga diletantë politikë të cilët kanë mbetur në lëndinë, pasi LDK-ja nuk po i bashkëngjitet këtij dialogu me njerëz që nuk kanë legjitimitet politik dhe kushtetues. Republika Serpska e ministrit tonë të Drejtësisë dhe e mentorëve të tij duhet të parandalohet me marrëveshjen e re. Prandaj, këtu qëndron edhe sikleti i tyre!", ka theksuar Mustafa në një intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re". Por njohësi i rrethanave politike Behxhet Shala ka thënë se nëse

jetësohet Asociacioni i Komunave Serbe me kompetencë ekzekutive do të sjellë luftë në Kosovë, por në një fazë të mëvonshme. "Jam i sigurt se këtu nuk do të ndodhë as lëvizja e kufijve e as këmbimi i territoreve sepse Serbia e ka për synim autonominë politike, ekonomike dhe territoriale për serbët e Kosovës e që do të krijohej një mekanizëm i përhershëm destabilizues, Asociacioni i Komunave Serbe dhe i cili, për aktivitetet destabilizuese, do të financohet nga buxheti i Kosovës, sikur Lista Serbe dhe bashkësia ndërkombëtare. Pra, jam shumë i sigurt se ndryshimi i kufijve të Kosovës do të shkaktojë luftë të menjëhershme sikur që jam i sig-

urt se edhe Asociacioni i Komunave Serbe në Kosovë, me kompetencë ekzekutive sikur Republika Srpska, nëse jetësohet (ky është qëllimi i Vuçiqit dhe lëshimi eventual i Thaçit), gjithashtu do të sjellë luftë në Kosovë, por në një fazë të mëvonshme. Statusin special për serbët në Kosovë në asnjë mënyrë nuk është dashur ta bëjnë kategori kushtetuese, por vetëm si diçka kalimtare, për një kohë të caktuar, derisa të stabilizohet shteti i Kosovës që kurrë nuk do të stabilizohet me këtë konjunkturë kushtetuese dhe me këta liderë politikë që i kemi", ka thënë Shala në një shkrim autorial të botuar në gazetën "Epoka e re".

Kapiteni i FSK-së, Fatmir Lami, shpallet më i miri në Universitetin Ushtarak në ShBA

PRISHTINË, 17 SHTATOR (ER) - Oficeri i FSK-së, kapiteni Fatmir Lami, pjesëtar i Batalionit të Logjistikës në BMO-së, ka marrë pjesë, nga data 28 shkurt 2018 e deri më 14 shtator 2018, në Kursin e Karrierës për Kapiten për Logjistikë, (LOGC3) 18-004, në Universitetin Ushtarak të Logjistikës (Army Logistics University) në Fort Lee, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në këtë kurs kanë marrë pjesë

oficerë të ushtrive nga Kosova, Japonia, Egjipti, Brazili, Greqia, Jordania, Turqia, Arabia Saudite, Estonia dhe Letonia. Në mesin e përfaqësuesve të këtyre vendeve, kapiteni i FSK-së, Fatmir Lami, është shpallur oficeri më i mirë ndërkombëtar në mesin e 13 oficerëve pjesëmarrës nga këto shtete të botës, ndërsa në nivel të përgjithshëm prej 119 pjesëmarrësve, Fatmiri ka zënë vendin e shtatë.



Flet për "Epokën e re" kryetari i OVLUÇK-së, Hysni Gucati

Prokuroria na ka f

- Prokuroria i ka pështjellë punët. Ajo duhet t'u kërkojë falje personave që ka fyer, duke i bërë veteranë të rremë dhe duke ua përlyer sakrificën për çlirimin e vendit

Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hysni Gucati, ka shprehur pakënaqësi ndaj prokurorisë për përfshirjen e veteranëve të vërtetë në listën e "veteranëve të rrejshëm". Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Prokuroria e Kosovës të gjithë procesin e ka shpënë në një qorrsoak. "Mendoj se në këtë rast është ngutur prokuroria që ka lejuar të bëhen listat publike duke e shkelur privatësinë e këtyre personave. Ndihej i zhgënjyer nga prokuroria se si ka arritur të bëjë gabime të tilla", ka thënë Gucati. Ai ka treguar se ditën e hënë janë ankuar mbi një mijë veteranë të vërtetë në degët e OVLUÇK-së në gjithë Kosovën. Gucati ka theksuar se nuk është ithtar i protestave, por i ka bërë thirrje Qeverisë ta fillojë rivlerësimin e gjithë këtij procesi

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hysni Gucati, ka kritikuar prokurorinë për përfshirjen e veteranëve të vërtetë në listën e "veteranëve të rrejshëm". Ai ka deklaruar se me këtë veprim prokuroria këtë proces e ka shpënë në një qorrsoak, duke krijuar mosbesim në organet e drejtësisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Gucati ka thënë se në këtë proces nuk mund t'i shpëtojë përgjegjësisë as politika. "Besimin tonë nuk mund ta lëkundin këto gabime, mirëpo e keqja është se me këto veprime të gabuara prokuroria na ka futur në qorrsoak. Këtu nuk mund të shpëtojë as politika nga përgjegjësia. Në këtë drejtim edhe politika ka faj, sepse ka mundësi se në prokurori ka ndërhyrë edhe politika. Tani unë, bashkëlufetarët e mi dhe qytetarët e Kosovës kanë të drejtë të frikësohen nga drejtësia. Mund të gabohet me një njeri ose dy, por jo të bëhen mijëra gabime", ka thënë Gucati.

Ai ka treguar se gjatë ditës së hënë mbi 1 000 veteranë të vërtetë kanë treguar në zyrat e OVLUÇK-së se janë gjendur në listat e publikuara. "Prej mëngjesit të ditës së hënë, në degët tona në gjithë Kosovën dhe këtu në qendër mbi 1 000 veta veteranë të vërtetë të UÇK-së janë lajmëruar se u ka dalë emri në këto lista", është shprehur Gucati. Më tej, ai ka treguar edhe si mund të zgjidhet ky problem. Gucati i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës që ta fillojë rivlerësimin e gjithë këtij procesi. "Këtë problem duhet ta zgjidhim bashkërisht, politika, prokuroria dhe organizatat e dala nga lufta e

UÇK-së. Unë i bëj apel edhe politikës, prokurorisë dhe institucioneve të tjera, si dhe organizatave të dala nga lufta, që t'i bashkojmë forcat dhe ta zgjidhin këtë problem njëherë e përgjithmonë. Ne kërkojmë nga politika, nga Qeveria e Kosovës, që ta fillojë rivlerësimin e gjithë këtij procesi me anë të një komisioni i cili do të punojë në bazë të kriterëve të sakta të përcaktuara me Ligjin e veteranëve të luftës së UÇK-së", ka thënë Gucati.

"Epoka e re": Z. Gucati, pas ngritjes së aktakuzës është bërë edhe publikimi në medie i listave me emra të veteranëve që, sipas prokurorisë, janë të rrejshëm. Cili është komenti juaj si kryetar i OVLUÇK-së?

Gucati: Edhe mua më ka habitur publikimi i listave. Në prokurori kam pasur një besim të fortë se do t'i zbardhë të gjitha rastet, mirëpo tash edhe neve na i ka pështjellë pak punët. Në ato lista ka shumë emra të veteranëve të vërtetë që i njoh edhe personalisht në Polac, Morinë, Rezallë, Kryshefc dhe fshatrave përreth. Mendoj se kjo që ka bërë prokuroria është një dobësi e madhe. Kështu që, edhe më tutje jam optimist se prokuroria do t'i përmirësojë gabimet që i ka bërë. Mendoj se në këtë rast është ngutur prokuroria që ka lejuar të bëhen listat publike duke e shkelur privatësinë e këtyre personave.

"Epoka e re": Çfarë mendoni se duhet të bëjë tash prokuroria, meqenëse po pretendohet se ka shumë gabime?

Gucati: Prokuroria jo vetëm se duhet në mënyrë sa më të shpejtë t'i bëjë këto përmirësime, por duhet të kërkojë falje publike ndaj këtyre individëve, emrat e të cilëve u njollosën, kurse mundi dhe sakrificat e tyre u përlyhen në

një listë, kinse ata kanë qenë veteranë të rrejshëm. Ndihej i zhgënjyer nga prokuroria se si ka arritur të bëjë gabime të tilla. Kjo është një fyerje për veteranët e vërtetë, sepse as familjarët dhe miqtë e tyre sot nuk ndihen mirë. Tashmë as fëmijët e veteranëve në shkolla nuk e ndiejnë veten mirë, ndonëse baballarët e tyre kanë qenë luftëtarë të UÇK-së prej fillimit deri në përfundim të luftës.

"Epoka e re": Keni kërkuar ndonjë sqarim nga prokurori se pse ka ndodhur ky publikim i listave në medie?

Gucati: Ne tashmë e kemi dërguar avokatin tonë si OVLUÇK në Prokurorinë Speciale, z. Gafurr Elshani. OVLUÇK-ja nuk mund të pajtohet me publikimin nga ana e medieve të listave të 'veteranëve të rrejshëm' të hartuara nga ana e Prokurorisë së Kosovës. Ne kërkojmë nga prokuroria ta sqarojë opinionin se si ka ardhur deri te hartimi dhe publikimi i saj në mediet publike. Duam të dimë se nga kush kanë rrjedhur këto lista, prej gjykatës apo prej prokurorisë.

"Epoka e re": Pas publikimit të këtyre listave kemi parë reagime të shumta nga ish-komandantë të UÇK-së, degë të OVLUÇK-së dhe personaliteteve të ndryshme. Është përmendur mundësia e ndonjë padie ndaj ish-prokurorit Elez Blakaj, si dhe mundësia e protestave. Do të merrni ndonjë veprim ju si OVLUÇK?

Gucati: Çdoherë kam thënë se nuk jam ithtar i protestave. Po ashtu, kam thënë se nuk duhet ta pengojmë prokurorinë në këtë proces. Duhet t'ia lëmë duart e lira prokurorisë për këtë çështje, sepse ajo është pushtet i ndarë dhe nuk duhet të ndikohet nga



askush. Ne nuk do të protestojmë tani, por i bëjmë thirrje prokurorisë që këto lista t'i pastrojë sa më shpejt dhe të kërkojë falje publikisht për shokët tanë që u ka vënë emrat në këto lista. Ne tani presim të dimë se kush i ka publikuar këto lista, prokuroria apo portalet, pa dijeninë e prokurorisë, dhe të ngrehim padi ndaj tyre.

"Epoka e re": Këto gabime të prokurorisë e kanë lëkundur besimin se këtë proces do të mund ta përfundojë në mënyrë të drejtë?

Gucati: Besimin tonë nuk mund ta lëkundin këto gabime, mirëpo e keqja është se me këto veprime të gabuara prokuroria na ka futur në qorrsoak. Këtu nuk mund të shpëtojë as politika nga përgjegjësia. Në këtë drejtim edhe politika ka faj, sepse ka mundësi se në prokurori ka ndërhyrë edhe politika. Tani unë, bashkëlufetarët e mi dhe qytetarët e Kosovës kanë të drejtë të

frikësohen nga drejtësia. Mund të gabohet me një njeri ose dy, por jo të bëhen mijëra gabime.

"Epoka e re": Sa veteranë të vërtetë ju kanë lajmëruar juve që u ka dalë emri në këto lista?

Gucati: Prej mëngjesit të ditës së hënë në degët tona në gjithë Kosovën dhe këtu në qendër mbi 1 000 veteranë të vërtetë të UÇK-së janë lajmëruar se u ka dalë emri në këto lista. Kemi diku dhjetëra komandantë të kompanive dhe togjeve që na kanë lajmëruar që emrat e tyre gjenden në këto lista. Po ashtu, përmbi 60 invalidë të UÇK-së janë lajmëruar se emrat e tyre gjenden në këto lista. Vetëm në zyrën time të hënë i kam pasur rreth 150 veta që janë ankuar për këtë çështje. Të gjitha këta janë të pajisur me dokumentacione, nga viti 1999 dhe deri me certifikatën e fundit që kanë marrë.

"Epoka e re": Për këtë gjendje e fajësuar edhe politikën. Në çfarë

utur në qorrsokak



kuptimi e bëni përgjegjës politikën në këtë proces?

Gucati: E vërteta është se politika është përzier edhe gjatë verifikimit të këtij procesi. Politikanë ta caktuar edhe publikisht e kanë përmendur se janë përzier gjatë verifikimit të veteranëve, duke treguar se kanë bërë lëshime. Tani edhe ne po dyshojmë se edhe politika është e përzier në këtë proces. Kjo është fyerja e dytë që po u bëhet veteranëve të UÇK-së. Fyerja e parë ka qenë në fillim kur i kanë përzier veteranët e vërtetë me ata jo të vërtetë dhe tani që vetë shteti, në këtë rast prokuroria, i ka fyer duke i cilësuar veteranët e vërtetë si të remë.

"Epoka e re": Si mund të zgjidhet ky problem? Kemi pasur deklarime të politikanëve të caktuar se këtë çështje nuk mund ta zgjidhë vetëm prokuroria.

Gucati: Këtë problem duhet ta zgjidhim bashkërisht, politika, prokuroria dhe organizatat e dala nga lufta e UÇK-së. I bëj apel edhe politikës, prokurorisë dhe institucioneve të tjera, edhe organizatave të dala nga lufta, që t'i bashkojmë forcat dhe ta zgjidhin këtë problem njëherë e përgjithmonë. Ne kërkojmë nga politika, nga Qeveria e Kosovës, që të fillojë rivlerësimi i gjithë këtij procesi me anë të një komisioni i cili do të punojë në bazë të kriterëve të sakta të përcaktuara me Ligjin e veteranëve të luftës së UÇK-së. Mendoj se kjo do të ishte më pak e kushtueshme dhe prokuroria do të lirohet në punën e saj.

Tonino Picula konfirmon përkrahjen për liberalizimin e vizave

PRISHTINË, 17 SHTATOR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur të hënën në takim delegacionin e Parlamentit Evropian, anëtarë të Komisionit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit BE - Kosovë, i kryesuar nga Tonino Picula.

Në emër të qytetarëve dhe institucioneve të Kosovës, kryeparlamentari Veseli ka falënderuar Piculën dhe anëtarët e tjerë të delegacionit për mbështetjen e pakursyer ndaj Kosovës dhe për vendimmarrjen e fundit të Parlamentit Evropian për procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës.

Veseli ka thënë se ky delegacion ka dhënë kontribut të çmuar

për arritjen e MSA-së për Kosovën, ndërsa tani si pjesë e komisionit të përbashkët me delegacionin e Kuvendit të Kosovës, përbën një forum të pazëvendësueshëm në mbështetje të Kosovës. "Ky takim i radhës që po mbahet mes dy komisioneve tona që merren me zbatimin e MSA-së bëhet në atmosferën shumë pozitive të krijuar pas përgjigjes pozitive që ka marrë Kosova për liberalizimin e vizave. MSA-ja ishte hapi parë i rëndësishëm në rrugëtimin e Kosovës për integrimin e saj evropian. Kosova është tërësisht e përkushtuar në vizionin e saj nacional për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian. Ne besojmë në këtë



vizion. Nuk kemi asnjë dilemë dhe as nuk mendojmë në alternativë tjetër strategjike. Ky përcaktim për të ardhmen i ka rrënjët në identitetin evropian të popullit dhe qytetarëve tanë", ka theksuar kryeparlamentari

Veseli. Ai ka thënë se liberalizimi i vizave do të shënojë një input të ri në marrëdhëniet e Kosovës me Bashkimin Evropian.

Ndërsa kryesuesi i delegacionit të Parlamentit Evropian, Tonino Picula, ka thënë se Kosova dhe

BE-ja duhet të qëndrojnë afër, ndërsa ka konfirmuar mbështetjen për Prishtinën zyrtare të delegacionit që ai drejton, në të gjitha fushat, me theks të veçantë, liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës.

Iowa i ofron përkrahje Kosovës edhe në fushën e mjekësisë

PRISHTINË, 17 SHTATOR (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka pritur të hënën në takim presidentin e "Mercy College of Health Sciences" të Iowa-s, Douglas Fiore, me të cilin ka biseduar rreth mundësive të bashkëpunimit në sektorin e arsimit, me theks të veçantë fushën e mjekësisë, konkretisht

programit të infermierisë. Dr. Fiore shfaqti gatishmërinë për të ofruar mbështetje për institucionet e arsimit në fushën e mjekësisë, me qëllim të aftësimin të rinjve përmes programeve të ndryshme, por edhe të mbështetjes praktike në infermieri. Ministri Bytyqi ka theksuar se MASHT-i ka bashkëpunim të

frytshëm me universitete dhe kolegje amerikane dhe mirëpret edhe gatishmërinë e "Mercy College of Health Sciences" të Iowas për bashkëpunim. Gjithashtu, Fiore ka pohuar se janë të gatshëm ta dërgojnë edhe një numër të konsiderueshëm të infermierëve për t'u angazhuar nëpër zonat rurale në Kosovë.



Përfaqësuesit e SBASHK-ut kërkojnë që sektorit të arsimit t'i rritet koeficienti i pagës

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të hënën në takim një delegacion të përfaqësuesve të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) të Republikës së Kosovës, me të cilët ka biseduar për pozitën dhe gjendjen aktuale të punëtorëve të arsimit, shkencës dhe kulturës në vendin tonë, duke vënë theksin në zhvillimet aktuale rreth Ligjit për Pagat i cili prek edhe të punësuarit në këta sektorë.

Përfaqësuesit sindikalë kanë shprehur qëndrimet e tyre kundër dispozitave të Projektligjit për pagat në sektorin publik, sipas të cilit, punëtorët e arsimit janë të ranguar shumë ulët në vlerën e koeficientit të pagave. Kërkesat e punëtorëve të sektorit të arsimit janë që të rritet koeficienti i pagave për sektorin e arsimit në kuadër të Ligjit për pagat. Kryeministri Haradinaj ka shprehur angazhimin e Qeverisë për të trajtuar arsimin si njërin prej prioritetëve kryesorë strategjike për zhvillimin e vendit dhe në këtë drejtim janë marrë veprimet që në vazhdimësi të krijohet një situatë shumë më e favorshme për ngritjen e nivelit të arsimit të gjeneratave të reja, duke shtuar se Ligji për pagat do



të trajtohet edhe në komisionet përkatëse parlamentare, nga ku mund të rrjedhin rekomandime të tjera në këtë drejtim. "Ne kemi nevojë për një edukim më të avancuar të rinisë në Kosovë. Kemi nevojë që brezat tanë të aftësohen për jetë dhe të jenë konkurrentë në tregun e punës me dijen dhe aftësitë që do të

fitojnë në procesin e arsimit", ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj dhe ka shtuar se për këtë pret kontributin e të gjithëve, në veçanti të atyre që janë të përfshirë në procesin e arsimit dhe edukimit në Republikën e Kosovës. Kryeministri Haradinaj ka theksuar edhe angazhimin e

Qeverisë për ta përmirësuar pozitën materiale të punëtorëve të arsimit. Në këtë kontekst, kryeministri Haradinaj ka përmendur miratimin nga Qeveria të Projektligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/991, i cili do ta tra-

jtojë angazhimin dhe sakrificën e të gjithë atyre që në periudhën më kritike e mbajtën gjallë arsimimin dhe edukimin në gjuhën shqipe në kohën më të vështirë. Në takim morën pjesë edhe ministri i Administratës Publike, Mahir Jagxhilar dhe ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi.

Aksioni 'Ta pastrojmë Kosovën' bëri bashkë më shumë se 109 mijë vullnetarë

Prishtinë, 17 shtator (ER) - Mbi 316 tonë dhe 46 mijë thasë me mbeturina kanë arritur të largohen brenda dy ditëve nga më shumë se 109 mijë vullnetarë falë aksionit të madh "Ta pastrojmë Kosovën", i cili filloi edhe zyrtarisht të shtunën, më 15 shtator, për të vazhduar deri më 15 dhjetor të këtij viti.

Aksioni i nisur me iniciativë të "Let's Do It Kosova" dhe i mbështetur nga Qeveria e

Republikës së Kosovës arriti një mobilizim të jashtëzakonshëm të mijëra vullnetarëve, institucioneve qendrore dhe komunale, organizatave dhe qytetarëve të shumtë.

Në konferencën për media ku u publikuan këto të dhëna, drejtori i "Let's Do It Kosova", Luan Hasanaj, ka thënë se ditët e para të fushatës kanë tejkaluar edhe pritshmëritë tona falë mijëra vullnetarëve që iu përgjigjen pozi-

tivisht thirrjeve të vazhdueshme për pjesëmarrje në aksione pastrimi.

Fushata e iniciuar nga "Let's Do It Kosova" ka bërë bashkë Qeverinë, komunat, ambasadat, KFOR-in, FSK-në, Policinë e Kosovës, organizatat joqeveritare, shoqërinë civile, kompani private, nxënës të shkollave fillore dhe të mesme, studentë dhe qytetarë të shumtë gjithandej vendit për një Kosovë më të pastër.



Në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) është përruar hapja e Klinikës Emergjente pas procesit të rinovimit

Rinovohet Klinika Emergjente, pajiset me aparaturën më moderne

Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka bërë me dije se janë investuar rreth gjysmë milion euro për transformimin e Klinikës Emergjente në një klinikë moderne dhe të pajisur me aparaturë të teknologjisë së fundit. Ai ka thënë se ky renovim nënkupton siguri më të madhe për pacientët dhe personelin mjekësor. Të pranishëm në përrimin e kësaj klinike kanë qenë edhe kryeparlamentari Veseli dhe kryeministri Haradinaj të cilët kanë premtuar kushte më të mira infrastrukturore në shëndetësi dhe shërbime më cilësore për pacientë

EPOKA
ERE

Faton DERMAKU

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Pas procesit të rinovimit, të hënë është bërë përrimi i hapjes së Klinikës Emergjente në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Të pranishëm në këtë ceremoni kanë qenë kryeparlamentari Kadri Veseli, kryeministri Ramush Haradinaj si dhe ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili.

do të kenë trajtim të dinjitetshëm. Falënderoj ministrin për punën e jashtëzakonshme të cilën është duke e bërë. Do të jemi bashkë në të gjitha proceset, për zgjidhjen e problemeve të qytetarëve dhe krijimin e kushteve sa më të mira për ta", ka deklaruar Veseli.

Ai ka theksuar se me këto investime të mëdha në infrastrukturën shëndetësore, furnizimet me pajisje dhe menaxhim efikas të

jtohen denjësisht dhe të mos kenë nevojë të dalin jashtë vendit. Kemi marrë vendim së bashku me kryeministrin dhe ministrin që t'i ngrehim pagat e gjithë personelit shëndetësor shumë shpejt. Jemi të përkushtuar që prej mesit të vitit të ardhshëm asnjë pacient të mos ketë nevojë të blejë barna në mënyrë private", është shprehur Veseli.

Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se me rinovimin e Klinikës Emergjente po vazhdon edhe rinovimi i shëndetësisë në vend. Ai ka theksuar se shëndetësia ka qenë e lënë pas dore gjatë, por tani ka ndryshuar diçka. "Kjo është një e arritur e shëndetësisë së Kosovës. Është rinovuar Reparti i Emergjencës, por nuk është vetëm ky repart. Shpreh falënderim për ministrin Ismaili, për punën, për të gjithë, sepse është duke u rinovuar shëndetësia në tërësi. Qendra Emergjente në QKUK është shndërruar në një klinikë moderne me pajisjet e teknologjisë së fundit. Pamja e

kësaj klinike, e krahasueshme me ato të vendeve evropiane, është dëshmi se po e rinovojmë tërë sistemin shëndetësor. Ne kemi mjekët dhe personelin mjekësor më të mirin në botë. U kanë munguar kushtet e pagat. Shëndetësia ka qenë e lënë pas dore gjatë dhe është hera e parë që ka ndryshuar diçka", ka deklaruar Haradinaj.

Kurse sa iu përket sigurimeve shëndetësore, ai ka thënë se nuk është proces i lehtë, sepse ka ndodhur një ndërprerje dhe duhet filluar nga e para. Sipas tij, duhet të investojë publiku njëherë paratë, për ta bërë një bazë në mënyrë që gradualisht pastaj të mbushet arka e sigurimeve nga kontribuuesit, nga ata që paguanë. "Prapë duhet t'i marrim në përgjegjësi ata që nuk kualifikohen, pra rastet sociale, mirëpo çka është lajm i mirë, është se lista esenciale po sigurohet gradualisht dhe po vjen dita kur pacienti nuk do t'i blejë më vetë barërat", ka theksuar Haradinaj, duke bërë me dije se sigurimet mund të bëhen deri në

vitin 2020.

Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë se në Qendrën Emergjente ka ndodhur një renovim i tërësishtëm, që nënkupton siguri më të madhe për pacientët dhe për personelin mjekësor. "Është një ditë e madhe për gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, por edhe për personelin shëndetësor, të cilët me të vërtetë kanë punuar në kushte të vështira, por tash e tutje do të kenë kushte më të mira. Edhe qytetarët do të marrin shërbime më të mira me pajisje moderne", ka thënë Ismaili. Ai ka bërë me dije se Ministria e Shëndetësisë ka investuar rreth gjysmë milioni euro që kjo klinikë të pajiset me aparaturë moderne. "Rreth gjysmë milioni euro investime për transformimin e Emergjencës në një klinikë moderne, të pajisur me aparaturë të teknologjisë së fundit, të denjë për t'i prituri qytetarët tanë në nevojë. E drejta për jetë është e panegociueshme, e me rinovimin e kësaj klinike ne kemi rritur shanset për mbijetesë të secilit që kërkon trajtim emergjent", ka thënë Ismaili.



Me këtë rast kryeparlamentari Kadri Veseli ka thënë se është ndjenjë e jashtëzakonshme t'i shohësh transformimet e mëdha që po ndodhin çdo ditë në shëndetësi. "Përruam investimet e bëra në rinovimin e Qendrës Emergjente të QKUK-së dhe furnizimin e saj me pajisje shëndetësore moderne. Me këto investime qytetarët që kanë nevojë për shërbime mjekësore

listës esenciale të barnave sektori i shëndetësisë po merr trajtimin e duhur. Veseli ka konfirmuar mbështetjen institucionale duke bërë me dije se shumë shpejt do të rriten pagat e personelit shëndetësor si dhe prej mesit të vitit të ardhshëm pacientët nuk do të blejnë barna. "Kemi një mesazh shumë të qartë: shëndetësia është shumë e shtrenjtë. Kemi vendosur që qytetarët tanë të tra-



Rikthehet taksa në Rrugën e Kombit



Shkëlqim Hysenaj (RFE/RL)

Në Rrugën e Kombit në Kalimash të Shqipërisë të hënën është rikthyer në fuqi tarifa për qarkullimin e automjeteve. Drejtori i Shoqatës së Transportit Rrugor në Kosovë në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, Ruzhdi Kurtishaj, ka thënë se taksa e vendosur për Rrugën e Kombit nga Shqipëria është tejet e lartë. Sipas tij, kjo taksë do t'u kushtojë kompanive transportuese 70 deri në 80 mijë euro në baza vjetore

banor do të verifikohen përpara se ta paguajnë tarifën e reduktuar. Kurse tarifa për automjetet nga Kosova do të jetë 660 lekë (5 euro). Për kalimtarët e shpeshhtë është premtuar zbritje prej 10 deri në 20 përqindësh në muaj.

Edhe motoçiklistët (klasa 1) do të paguajnë 2.50 euro, minibusët dhe makinat 5 euro (klasa 2), autobusët (klasa 3) 11.30 euro, kamionët e vegjël (klasa 4) 16.30 euro dhe kamionët e mëdhenj (klasa 5) do të paguajnë 22.60 euro. Gjatë ditës së hënë një numër simbolik i qytetarëve dhe shoqërisë civile kanë protestuar në qendër të qytetit të Kukësit për rivendosjen e kësaj pagese, duke e cilësuar atë si "thellim të ndarjes së Shqipërisë me Kosovën".

Kjo protestë kaloi e qetë. Mirëpo, ky vendim i Qeverisë shqiptare nuk është pritur mirë nga autoritetet e Kosovës. Drejtori i Shoqatës së Transportit Rrugor në Kosovë në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, Ruzhdi Kurtishaj, ka deklaruar për

gazetën "Epoka e re" se taksa e vendosur për Rrugën e Kombit nga Shqipëria është tejet e lartë. Sipas tij, kjo taksë do t'u kushtojë kompanive transportuese 70 deri në 80 mijë euro në baza vjetore. Ai ka thënë se nuk janë duke kundërshtuar taksën, por janë duke e kundërshtuar shumën e pagesës. "Të jemi të qartë, ne nuk jemi duke e kundërshtuar taksën, por shumën e lartë që është vendosur. Taksa ka implikime tek secili anëtar i Shoqatës së Transportuesve Rrugorë të Udhëtarëve sepse shumicën e punëve e bëjmë në atë drejtim. Si taksë nuk e shohim si problem, por si shumë", ka thënë Kurtishaj.

Ai ka deklaruar se në mbledhjen e fundit që ka pasur Shoqata e Transportit Rrugor në Kosovë ka dalë me dy përfundime. "Shoqata ka mbajtur të hënën mbledhjen me këtë pikë të rendit të ditës - taksa për Rrugën e Kombit dhe kemi dalë me konkludimin se taksa nuk kundërshtohet, por shumën e taksës sepse është

shumë e lartë dhe të gjithë kërkojnë që shumën të jetë vetëm pesë euro. Në këtë drejtim kërkojmë që autobusët të kenë trajtim tjetër. Shqipëria nga turizmi merr mbi 1 miliard euro, gjë që shkon përmes kompanive transportuese dhe qytetarëve. Ne nuk po kërkojmë asgjë të veçantë, por që taksa të jetë pesë euro e përballeshme, pasi taksa aktuale mund të ndikojë edhe në ngritjen e çmimit të biletave dhe orientim në tregjet e reja. Kjo taksë na ngarkon në baza vjetore, diku 70 deri në 80 mijë euro dhe është barrë e rëndë", ka thënë Kurtishaj.

Ndërkaq në komunikatën për medie të Shoqatës së Transportit Rrugor të Udhëtarëve thuhet se jashtë sezonit janë 20 deri në 30 autobus që në baza ditore mbajnë linjat e rregullta nga Kosova në Shqipëri. Gjatë fundjavës numri i autobusëve që qarkullojnë në rrugën e kombit arrin shifrën nga 50 deri në 60 autobus, kurse gjatë sezonit turistik kjo shifër arrin deri në 100 autobus përgjatë ditës.

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Në Rrugën e Kombit në Kalimash të Shqipërisë të hënën është rikthyer në fuqi tarifa për qarkullimin e automjeteve. Por, pas disa muajsh negociata me banorët, qeverinë dhe koncesionarin, është vendosur që banorët e Kukësit dhe zonave përreth tij të paguajnë një tarifë të reduktuar. Kurse, më 31 mars të këtij viti, në Kalimash, te sportelet ku paguhet taksa, ka pasur protesta të dhunshme nga

banorët e Kukësit, për të cilët ka qenë e paraparë të paguajnë të njëjtën tarifë si kalimtarët e tjerë prej pesë eurosh për një drejtim. Në këto protesta qytetarët e revoltuar ua vunë zjarrin sporteleve duke i lënë të shkatërruara.

Në sportele do të bëhet verifikimi i targës dhe banorët e kësaj ane do të përfitojnë tarifën e reduktuar prej 100 lekësh (rreth 80 centë) me TVSh.

Çdo mjet që i korrespondon Qarkut të Kukësit, targat e të cilave kanë hyrë në sistem, dhe çdo



Papunësia në tremujorin e dytë, afër 30 për qind

EPOKA
ERE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) për tremujorin e dytë (TM2) 2018. Anketa ka pasur shtrirje në 598 qarqe regjistruese në tërë territorin e vendit, ku janë anketuar 3 462 ekonomi familjare, të përzgjedhura sipas metodës së rastit, nga Korniza e regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave 2011. Ekonomitë familjare, të selektuara për anketim, përveçse kanë pasur një

anketim, kanë pasur edhe tri rianketime sipas periudhës referuese.

Ky publikim përmban të dhëna të detajuara mbi punësimin dhe papunësinë sipas moshës, gjinisë, statusit të punësimin, aktiviteteve ekonomike, profesioneve dhe çështjeve të tjera të ngjashme, që kanë të bëjnë me tregun e punës.

Sipas rezultateve të dala nga ky publikim, dy të tretat e popullsisë në Kosovë janë popullsi në moshë pune. Në popullsinë e moshës së punës përfshihen moshat 15-64-vjeçare. Në kuadër të popullsisë në moshë të

punës, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është 40.4 për qind.

Shkalla e punësimin në Anketën e Fuqisë Punëtore (AFP) për tremujorin e dytë (TM2) 2018 është 28.5 për qind.

Punësimi më i lartë është te meshkujt (44.8 për qind), ndërsa punësimi te femrat është 12 për qind. Femrat janë të punësuar, kryesisht në sektorët e arsimit, tregtisë dhe kujdesit shëndetësor, me 52.8 për qind të tyre, ndërsa meshkujt janë kryesisht të punësuar në sektorët e tregtisë, ndërtimtarisë dhe prodhimit me 41.5 për qind.

Sektorët ekonomikë që prijnë me punësim vazhdojnë të jenë: tregtia me 16.8 për qind, arsimit me 11.7 për qind, ndërtimtarisë me 11.6 për qind si dhe prodhimi me 9.5 për qind. Ndërsa sektorët e tjerë marrin pjesë me përqindje më të vogël në punësim.

Sa iu përket të punësuarve me kontrata, del se 20.4 për qind e personave të punësuar kanë kontratë të përhershme në punën e tyre kryesore, ndërkohë që 79.6 për qind kanë kontratë të përkohshme.

Sipas rezultateve të AFP-së, në TM2 2018 shkalla e papunësisë

është 29.4 për qind.

Papunësia më e theksuar është te femrat me 30.6 për qind, krahasuar me meshkujt, 29.1 për qind. Shkalla më e theksuar e papunësisë është te grupmoshat 15-24-vjeçare me 55 për qind.

Sipas rezultateve të AFP-së në TM2 2018, fuqia joaktive është mjaft e lartë me 59.6 për qind, me fokus të veçantë te femrat me 82.6 për qind, krahasuar me meshkujt 36.9 për qind.

Për realizimin e AFP-së TM2 2018, metodologjia dhe standardet e aplikuar nga ana e ASK-së janë të harmonizuara me rekomandimet e Eurostatit.

Në Stamboll prezantohet sistemi tatimor i Kosovës

PRISHTINË, 17 SHTATOR (ER) - Javën e kaluar në Stamboll të Turqisë është mbajtur një sesion informues "Klima e investimeve në Kosovë", me synim të veçantë diasporën shqiptare. Në këtë konferencë nga ATK-ja ka marrë pjesë drejtori i përgjithshëm, Sakip Imeri, i cili ka prezantuar sistemin tatimor të Kosovës. Ai i ka njoftuar pjesëmarrësit e këtij sesioni se

Kosova ka sistemin tatimor modern, bazuar në standardet ndërkombëtare dhe parimet e BE-së, legjislacion të thjeshtë, sistem të integruar të regjistrimit të biznesit, ngarkesa të ulëta tatimore, shërbime elektronike për deklarimin dhe pagesën e tatimeve, si dhe lehtësi të tjera për tatimpagues në zhvillimin e biznesit të tyre.

Përpos të tjerash, drejtori Imeri ka theksuar se prodhuesit e Kosovës gëzojnë liri për TVSh-në në linjat e prodhimit, makineritë dhe lëndën e parë që përdoren në procesin e prodhimit, po ashtu liri për pajisjet e TI-së dhe burimet e energjisë. Gjithashtu, vlen të theksohet se Kosova ka marrëveshje me Turqinë për eliminimin e tatimit të dyfishtë.



Në Prizren fillon lirimi i hapësirave të uzurpuara të Hekurudhës

PRIZREN, 17 SHTATOR (ER) - Hekurudhat e Kosovës, në bashkëpunim me Komunën e Prizrenit, kanë intervenuar të hënën për lirimin e hapësirës që është pronë e hekurudhave, e që kjo pronë është uzurpuar nga qytetarët, ku më pas do të bëhet revitalizimi i trasesë së hekurudhës për ta vënë në funksion lëvizjen e trenave pas një periudhe në këtë qytet. Është bërë me dije se ky aksion për lirimin e hapësirave të uzurpuara të Hekurudhës do të vazhdojë edhe në ditët e ardhshme.



Diskutohet rregullorja për ndarjen e çmimeve në emër të Komunës së Gjilanit

GJILAN, 17 SHTATOR (ER) - Komuna e Gjilanit e ka vënë në dëgjim publik rregulloren për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve, përpara se ky akt normues të dërgohet për miratim në Kuvend Komunal nga fundi i vitit.

Shefi i Zyrës Ligjore në Komunën e Gjilanit, Hevzi Matoshi, ka thënë se në bazë të kësaj rregulloreje Kuvendi Komunal i Gjilanit jep titujt "Qytetar Nderi", "Nderi i Qytetit",

çmimin letrar "Beqir Musliu", çmimin "Agim Ramadani" dhe çmimin "Idriz Seferi" si dhe mirënjohje e shpërblime të tjera për personalitete të shquara dhe subjekte juridike, si shenjë nderimi për sakrificën dhe kontributin e veçantë në fushën e humanizmit, sakrificës, kulturës, artit, sportit dhe në fusha të tjera.

Pas marrjes së vendimit nga Kuvendi Komunal për ndarjen e titullit të caktuar, kryetari i komunës

organizon ceremoninë e dorëzimit të titullit, sipas protokollit të paraparë. Sipas tij, ndryshimi nga rregullorja ekzistuese e vitit 2011 është se tani janë propozuar dy çmime të reja: çmimi "Agim Ramadani" dhe çmimi "Idriz Seferi".

Ndërsa Veton Nevzadi nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka kërkuar që komuna të ndajë edhe një shpërblim për arritje shkencore, i cili do të quhej çmimi "Xhavit Ahmeti".

Begaj viziton Gjimnazin 'Hamdi Berisha' me rastin e fillimit të mësimt

MALISHEVË, 17 SHTATOR (ER) - Me rastin e fillimit të procesit edukativo-arsimor në Gjimnazin "Hamdi Berisha" në Malishevë, kryetari i komunës, Ragip Begaj, ka vizituar nxënësit dhe mësuesit në këtë gjimnaz. Ai është zotuar se si komunë do ta përkrahin këtë institucion arsimor. Begaj ka bërë me dije se Gjimnazi "Hamdi Berisha" aktualisht është duke pritur edhe fillimin e punës së

aneksit i cili do të mundësojë kushte më të mira për të gjithë komunitetin shkollor që zhvillon mësimin e rregullt në këtë vatrë diturie. Kryetari Begaj në fund të fjalës së tij ka kërkuar nga të gjithë, mësuesit, nxënësit, punëtorët teknikë, ekipi drejtues i shkollës dhe prindërit angazhim maksimal që kjo vatrë e diturisë të jetë shembull i suksesit dhe përkushtimit për dije.



Komuna e Kaçanikut në proces të realizimit të 19 projekteve kapitale

KAÇANIK, 17 SHTATOR (ER) - Nën kryetari i Komunës së Kaçanikut, Ylber Bajra, është takuar të hënën me ekzekutivin komunal në kuadër të mbledhjes së fillimjavës. Në këtë mbledhje është bërë me dije se punimet në projektet kapitale janë duke vazhduar sipas dinamikës së paraparë. Po ashtu, është bërë me dije se

tashmë janë duke u realizuar në terren 19 projekte kapitale që kanë synim rregullimin e mirëqenies qytetare. Nën kryetari Bajra ka thënë se java që sapo lamë pas ishte e mbushur me shumë aktivitete komunale, aktivitete kulturore e sportive, aktivitete vetëdijësuese në mbrojtjen e ambientit etj.



Ministri Lekaj e bën Klinën edhe me një rrugë të re

KLINË, 17 SHTATOR (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, të hënën mori pjesë në fillimin e ndërtimit të rrugës në Krushevë të Klinës. Kjo rrugë do të realizohet me investim të Ministrisë së Infrastrukturës në kuadër të mbështetjes së nivelit qendror që po u jepet komunave.

Rruga e re e Krushevës do t'i lidhë mes vete lagjet e këtij fshati

dhe do ta lehtësojë qarkullimin e lirë e të papenguar të banorëve të këtij lokaliteti. Rruga e filluar në Krushevë të Klinës kushton mbi 270 mijë euro dhe lidhë tri lagjet e këtij fshati me mbi 300 banorë. Duke deklaruar për mediat, ministri Pal Lekaj ka thënë se Klinë po i kthehet vëmendja e munguar ndër vite dhe ky projekt që po fillon sot

nuk është i vetmi, por që duhet bashkëpunimi edhe i banorëve për realizimin e këtij projekti dhe të gjitha projekteve të tjera. Ndërkaq kryetari i Klinës, Zenun Elezaj, ka falënderuar ministrin Lekaj për mbështetjen e vazhdueshme si në këtë projekt, po ashtu edhe në një sërë projektesh të tjera që janë duke u implementuar në Klinë.

(Reagim ndaj platformës serbe të hartuar nga Thaçi)

FATIN E KOSOVËS E VULOSIN QYTETARËT E SAJ



Jakup KRASNIQI

Kam pas lexuar diku, mbase ishte përrallë e cila thoshte se një mbreti i kishin dalë brirët dhe kush e shihte mbretin me brirë e përhapte lajmin, lajmësi vritej. Njëri që e kishte parë mbretin me brirë hyri në një kallamishte dhe thirri disa herë: "Çka s'ke n'di e çka s'ke pa, mbreti ynë brirë ka"! Kur nga kallami bënë fyell, fyelli thoshte të njëjtën gjë. Dhe kështu lajmi mori dhen. Ajo edhe mund të ketë qenë përrallë, ndërsa kjo që do të lexoni në vazhdim nuk është përrallë. Është e vërtetë.

Presidenti ynë brirë nuk ka, por këtë çmenduri që e paska thënë, po ta thoshte Vuçiqi,

presidenti normal i vendit tonë do të duhej ta ngrehte zërin në selinë e BE-së në Bruksel, në Shtëpinë e Bardhë në Uashington dhe në kryeministrin e Mbretërisë së Bashkuar në Londër dhe kudo që do të arrinte. Jo, ai është bërë zëdhënës i kësaj maskarade. Lexojeni se çka paska deklaruar: "Dikush mund të thotë se Serbia duhet ta njohë Kosovën pa kushte dhe brenda këtyre kufijve. Edhe unë dua të njëjtën gjë. Por, a mendoni se ne do ta bindim Serbinë ta bëjë një gjë të tillë së shpejti? Fatkeqësisht, jo. Po BE-ja dhe aleatët tanë të fuqishëm: ShBA-ja, Gjermania, Anglia, Franca, Italia e shumë të tjerë, a mendoni se do ta bindin Serbinë ta njohë Kosovën? Përsëri, jo. Nuk kanë mundur ta bindin të bëjë një gjë të tillë deri më sot dhe nuk mund të garantojnë se do ta bëjnë nesër apo në të ardhmen e afërt. Si rezultat, përgjegjësia mbetet tek ne". Deklarim më finok, mbase as

kaq finok, nuk do ta nxirrte asnjë shqiptar, serbët janë mjeshtër të këtyre gjerave të programuara.

Por, as këto turpe që janë renditur më lartë sesa kryeturpi i Thaçit i cekur më parë, nuk qëndrojnë prapa: "Nuk mund t'i arrijmë këto qëllime, nuk mund ta vulosim njëherë e përgjithmonë fatin e Kosovës si shtet, nëse në muajt e ardhshëm nuk do ta bëjmë marrëveshjen ligjërisht obliguese me Serbinë". Pse kjo me kaq ngutësi lidhet me muajt e ardhshëm? Pse muajt e deri tashëm ishin ndryshe?

"Marrëveshja mund të arrihet vetëm nëse palët bëjnë kompromis". Jo zotëri Thaçi, kompromiset i kemi kryer në bisedimet e Vjenës. Këto nuk janë kompromise, këto janë më shumë se kompromime, ky është kulmi i papërgjegjësive nga njeriu i parë i shtetit. "Por, realiteti është edhe më kokëfortë se argumentet tona". Mos po donë presidenti i papërgjegjshëm të na thotë se ne nuk kemi argu-

mente për pavarësi? Dhe vazhdon me argumentin tradicional serb: "Njohja nga Serbia është bërë pengesa primare për rrugëtimin tonë euroatlantik". Jo zotni, mos njohja nga Serbia nuk është pengesë, pengesë janë dhjetë vitet e qeverisjes sate me të gjitha ata që t'u bënë argatë në realizimin e Marrëveshjen e 19 prillit 2013, me miratimin e saj.

Për këto deklarata të Thaçit, kam bindjen se i ka mirëpritur ASHAS-ja dhe po qese Universiteti i Beogradit do ta ftonte për t'ia dhënë titullin Honorise Causa, nuk do të habitesha. Ndoshta, ai po e synon diçka më shumë, po e synon çmimin Nobel për paqe?! Një çmim të ngjashëm për paqe para sa vitesh e kanë pas ndarë një udhëheqës Izraelit me një Palestinez, por paqja nuk është arritur as sot e kësaj dite. Me këto veprime të presidentit të papërgjegjshëm të Kosovës, shërbim më të mirë shtetit serb, Serbisë që nga koha e udhëheqësve komu-

nistë shqiptarë (1945-1989) nuk i është bërë. Madje, është një shembull tipik, si një veprimi i një matrapazi (që s'po ia përmendi emrin), i para disa vjetëve, pas vendosjes së kufijve të Shqipërisë Londineze caktuar nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër dhe njohjes së saj nga Lidhja e Kombeve në Konferencën e Paqes në Paris më 1919!

Ta themi edhe këtë: Kushdo që ka pasur mundësin t'i lexonte deklaratat e udhëheqësve shqiptarë të viteve të '80-ta, të atyre që e kishin përfaquar politikën e LKJ-së, e sheh se ato deklarata kishin më shumë dinjitet se këto të Thaçit 20 vjet pas luftës çlirimtare?! Edhe pse shkalla e rrezikshmërisë për udhëheqësit e viteve të '80-ta ishte e pakrahueshme me ketë të sotmen. Për faktin se Serbia është krejt jashtë Kosovës dhe federata jugosllave nuk ekziston më.

Të gjithë në mbrojtje të tërësisë territoriale të Republikës! Të gjithë për një platformë për Kosovën!

HUQJA E PROKURORISË SPECIALE TË KOSOVËS



Lulëzim ETEMAJ

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës duket se ka probleme tepër të mëdha në raport me ish-pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Fillimisht, javën e kaluar, me rastin e ngritjes së aktakuzës kundër 12 personave për mashtrim me statusin, ajo ka shkelur në mënyrë flagrante të drejtat e tyre njerëzore themelore, meqenëse, sipas disa të akuzuarve të saj, ata nuk janë informuar paraprakisht në rrugë zyrtare dhe direkt për aktakuzën, por lajmin e kanë mësuar nga mediat.

Tani kanë qenë mediat ato që kanë publikuar listën nga aktakuza e Prokurorisë Speciale me veteranë të rrejshëm. E, në mesin e veteranëve të rrejshëm,

sipas reagimeve të para, qoftë të personave të apostrofuar, qoftë të komandantëve e të bashkëluftëtarëve të tyre, janë gjendur edhe një numër i madh i luftëtarëve të vërtetë të UÇK-së, madje ka prej tyre që ishin pjesëtarë të saj që nga fillimi. Pakënaqësia dhe indinjata e shprehur publikisht, duket që e ka nxitur edhe ish-prokurorin e Prokurorisë Speciale të Kosovës, Elez Blakaj, për të reaguar dhe dhënë shpjegime shtesë rreth listës së aktakuzës së veteranëve. Blakaj, përmes një postimi në profilin e tij në "Facebook" ka thënë se aktakuza e tanishme e Prokurorisë Speciale të Kosovës ka pësuar ndryshime nga ajo që e ka përpiluar ai. Sipas ish-prokurorit Blakaj, janë rreth 2.000 persona më shumë të përfshirë tani në listë, për të cilët ai nuk ka informacione se si janë përfshirë në aktakuzë. Në shërbim të së vërtetës, të cilën e duan të gjithë, Blakaj do të duhej ta publikonte tani listën e tij të cilën ai ka deklaruar se e ka marrë me vete në

SHBA. Kjo deklaratë e Blakajt e bën edhe më të ndjeshme çështjen e trajtimit të listave të veteranëve të rremë të UÇK-së. Njëkohësisht ajo e nxjerr në pah mungesën e profesionalizmit dhe paaftësinë e Speciales së Kosovës për të dalë para opinionit publik me një aktakuzë të bazuar, që adreson saktë pritet si të institucioneve gjegjëse të shtetit ashtu dhe të opinionit publik për të gjykuar dhe ndërprerë keqpërdorimin e buxhetit të shtetit nga ana e veteranëve të rremë. Huqja e tillë juridike që në start, jo vetëm që e rritë mosbesimin në drejtësinë e Kosovës dhe mekanizmat e saj, por hap dilema të mëdha për sa i përket raportit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës jo vetëm me ish ushtarët e UÇK-së, por edhe me vetë UÇK-në. Kështu, i gjithë rasti, merr pashmangshëm konotacione politike. Rrethanë rënduese në të gjithë këtë spektër paraqet fakti se drejtësia e Kosovës dominohet nga ish gardianë të

drejtësisë serbosllave, e cila, siç dihet, kishte orientim themelorë shtypjen e të drejtave të ligjshme njerëzore dhe kombëtare të shqiptarëve të Kosovës. E, gardianët e tillë, janë element shumë i përshtatshëm për instrumentalizime të llojllojshme në këmbim të rehatisë së tyre, mirëqenies sociale dhe karrierës profesionale.

Gardianët e drejtësisë në Kosovë, në këtë rast prokurorët dhe gjyqtarët, duhet të jenë të pavarur nga politika dhe ndikimet tjera, porse, politika duhet që përmes mekanizmave të saj, posaçërisht Kuvendit të Kosovës, t'i përkrah ata përmes nxjerrjes, rishikimit dhe plotësimit të ligjeve si dhe mbikëqyrjes së zbatimit të tyre. Nuk mund të bësh një ligj të tillë si ai për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e të befasohesh më pastaj me efektet nëpërkëmbëse dhe rrënuese të dinjitetit të luftëtarëve të lirisë, të UÇK-së dhe luftës së saj. Është obligim i Kuvendit të Kosovës që në

bashkëpunim të ngushtë me Shoqatën e Veteranëve të UÇK-së t'i japi zgjidhje të ngutshme politike qorrrokakut në të cilin Prokuroria Speciale e Kosovës e ka futur çështjen e veteranëve të rremë, e cila tashmë siç duket është shndërruar nga segmente të caktuara të drejtësisë së Kosovës në kauzë të qërimin të hesapeve me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe ish ushtarët e saj.

Po ashtu është detyrë themelore e Shoqatës së Veteranëve të UÇK-së t'i marrë në mbrojtje veteranët e akuzuar pa bazë nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, të mos i lë vetëm për t'u mbrojtur, por të mbledhë fakte rreth përfshirjes së tyre në listën e veteranëve të rrejshëm dhe të bëjë padi penale kundër nëpërkëmbjes së dinjitetit të këtyre luftëtarëve dhe vetë UÇK-së. Goditjet e tilla të ulëta s'duhet të kalojnë! Në të kundërtën, dro që askush s'do të mund t'i dali para paqes së brishtë sociale dhe ta ndali ngarënia në humnerë.

Republikanët kërkojnë të shtyhet votimi për gjykatësin Kavanaugh

WASHINGTON, 17 SHTATOR - Disa republikanë kërkojnë që votimi për Brett Kavanaugh, i emëruar nga presidenti amerikan Donald Trump, për gjykatës të Gjykatës Supreme të ShBA-së, duhet të ndalet derisa të dëgjohen akuzat kundër tij për sulme seksuale. Thirrja vjen pasi Christine

Blasey Ford e akuzoi Kavanaugh për sulm ndaj saj në fillim të viteve 1980. Kavanaugh i mohon akuzat, të cilat kanë dalë pak ditë përpara se Komiteti Gjyqësor i Senatit të votojë për postin. Edhe Kavanaugh, edhe Ford thanë se janë të gatshëm të dëshmojnë

para panelit. Këshilltarja e Shtëpisë së Bardhë, Kellyanne Conway, tha se Ford "nuk duhet të fyhet ose injorohet" dhe se duhet të dëshmojë nën betim. Senatori republikan i Arizonës, Jeff Flake, tha se dëshmia e Ford duhet të dëgjohet. "Duhet ta

dëgjojmë. Dhe mendoj se nuk jam i vetmi që mendoj kështu", tha Flake. Republikani Bob Corker tha se votimi duhet të shtyhet derisa Ford të dëgjohet, ndërsa republikania Lisa Murkowski tha se shtyrja është "diçka që duhet të konsiderohet".



Samiti ndërkorean, pritet zgjidhja për bisedimet bërthamore në mes të Phenianit dhe Uashingtonit

Samiti ndërkorean do të jetë një test i rëndësishëm për një tjetër takim që Kim Jongu ka propozuar së fundi me presidentin amerikan, Donald Trump, në pritje të garancive mbi seriozitetin e Kimit mbi denuklearizimin, një angazhim që e ka bërë që në përballjen e parë me shefin e Shtëpisë së Bardhë në qershor

SEUL, 17 SHTATOR - Presidenti korean-jugor Moon Jaein pritet ta kalojë zonën kufitare tejet të militarizuar gjatë ditës së sotme (e martë), për atë që do të jetë samiti i tij i tretë me udhëheqësin korean-verior, Kim Jongun, me synimin për ta gjetur zgjidhjen e shumëpritur në bisedimet e ngecura bërthamore në mes të Penianit dhe Uashingtonit. Samiti ndërkorean do të jetë një test i rëndësishëm për një tjetër takim që Kim Jongun ka propozuar së fundi me presidentin amerikan, Donald Trump, në pritje të garancive mbi seriozitetin e Kimit mbi denuklearizimin, një angazhim që

e ka bërë që në përballjen e parë me shefin e Shtëpisë së Bardhë në qershor. Trumpi i ka kërkuar Jae-in të jetë "kryenegociatori" mes tij dhe Kim Jongunit, sipas ndihmësve të Moon, pasi Trumpi anuloi një udhëtim të planifikuar në Phenian të Sekretarit të tij të Shtetit, muajin e kaluar. "Do të më pëlqente të kisha një dialog të sinqertë me udhëheqësin Kim, për të gjetur një pikë kontakti mes kërkesave të Amerikës për denuklearizimin dhe kërkesave të Koresë së Veriut për dhënie fund të marrëdhënieve armiqësore dhe pasjen e garancive të fushës së sigurisë", tha Moon të



hënën. Moon, i cili edhe vetë është pasardhës i një familjeje të zhvendosur që prej luftës koreane të viteve '50-'53, do të udhëtojë drejt kryeqytetit të Veriut komunist, Phenian, ku do të zbrësë në orën 10 të paradites sot (e martë) me atë lokale, njoftoi shefi i stafit të tij, Im Jong-seok të hënën.

Ai pret të mirëpritet nga Kimi përpara ceremonisë zyrtare të mirëseardhjes. Dy udhëheqësit koreanë do të ulen për bisedime formale pas drekës, e më pastaj do të pasojë një shfaqje muzikore dhe darka e mirëseardhjes. Moon do të shoqërohet nga drejtues të lartë të Samsungut, "SK

Group" dhe "LG Group", gjatë takimeve të tij. Nesër (e mërkurë), Moon dhe Kim pritet të japin një deklaratë të përbashkët, si dhe të nënshkruajnë një pakt ushtarak që synon t'i largojë tensionet dhe t'i parandalojë përplasjet e armatosura. Moon do të kthehet në Seul në orët e para të së enjtes.

Mattis fton maqedonasit të votojnë pro në referendumin e 30 shtatorit

SHKUP, 17 SHTATOR - Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Jim Mattis akuzoi Rusinë të hënën për përpjekje për të ndikuar në rezultatin e referendumit për ndryshimin e emrit të Maqedonisë. Vota në mbështetje të ndryshimit të emrit, do t'i hapte Shkupit rrugën për anëtarësim në NATO dhe në Bashkimin Evropian. Duke folur në Shkup me udhëheqësit e Maqedonisë, sekretari Mattis tha gjithashtu se Shtete e Bashkuara po shqyrtojnë zgjerimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë kibernetike me këtë

vend të Ballkanit. Maqedonasit do të votojnë më 30 shtator për një marrëveshje të nënshkruar në qershor mes Maqedonisë dhe Greqisë që do t'i ndryshonte emrin vendit nga Republika e Maqedonisë në Republika e Maqedonisë së Veriut. Athina kërkonte ndryshimin e emrit që të votonte pro anëtarësimin të Shkupit në NATO dhe BE. "Ne nuk duam të shohim Rusinë të bëjë (në Maqedoni) atë që është përpjekur të bëjë në shumë vende të tjera", tha sekretari Mattis për gazetarët që po udhë-



tonin me të drejt Shkupit, duke iu referuar shqetësimeve të Uashingtonit rreth ndërhyrjes

ruse në zgjedhjet presidenciale amerikane të vitit 2016. "Nuk ka dyshim që ata kanë transferuar

para dhe po ndërmarrin një fushatë të gjerë ndikimi", tha Mattis, duke shtuar se nuk është e qartë se sa efektive kanë qenë përpjekjet e Moskës për të ndikuar te referendumi në Maqedoni. Rusia i ka mohuar akuzat për ndërhyrje, por i kundërshton me forcë planet e Maqedonisë për anëtarësim në NATO. Sekretari Mattis është zyrtari i fundit i lartë perëndimor, përfshirë kancelaren Angela Merkel që viziton Maqedonisë ditët e fundit për t'u bërë thirrje qytetarëve të saj të miratojnë referendumin.

Putini dhe Erdogani bisedojnë për krizën në Idlib

Moskë, 17 shtator - Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin dhe ai i Turqisë, Rexhep Erdogan u takuan të hënën në vendpushimin rus të Soçit në Detin e Zi, në përpjekje për të gjetur një zgjidhje diplomatike për krizën në rajonin Idlib të mbajtur nga kryengritësit në Siri.

Provinca e Idlibit në veriperëndim të vendit është bastioni i fundit i kryengritësve sirianë dhe Turqia është treguar mjaft e interesuar për të parandaluar një ofensivë të mundshme qeveritare atje. Presidenti Rexhep Tajip

Erdogan takohet me presidentin Vladimir Putin për herë të dytë gjatë 10 ditëve, pasi Rusia dhe Irani shprehën mbështetje për idenë e një ofensive. Rusia e quan Idlibin një shtrat të terrorizmit dhe thotë se Qeveria siriane ka të drejtën të


rimarrë kontrollin e tij. Turqia i ka bërë thirrje Rusisë dhe Iranit, për një zgjidhje diplomatike të situatës, që vlerësohet si mjaft shpërthyes. Në të njëjtën kohë, ajo ka dërguar përforsime për trupat e saj në afërsi të Idlibit, një hap që synon të shmangë të paktën



përkohësisht një ofensivë tokësore në terren.

ALEKSANDËR MOISIU, FANTAZMA E SHEKULLIT XX

*Zoti Moisi, më lejoni t'ju përqafoj,
që njerëzit të mendojnë se edhe
unë jam dikush / Ernst Lubiç*



RÜDIGER SCHAPER

Moisiu, një zë joshës, ogurzi, i mistershëm. Sapo t'ia dëgjojë emrin, njeriu e lidh me filmin e viteve '20 të shekullit të kaluar. Moisiu përshoqërohet me filmat "Mabuse", "Metropolisi", "Një qytet kërkon një vrasës", asokohe paralajmëruet të barbarisë naziste nëpërmes një mediumi revolucionar, "kanavaca demonike" siç e përkufizonte filmin në atë kohë Lotte Ajsneri, historiane e kinematografisë. Gjurma tek filmi nuk është krejt e huqur, por çon, megjithatë, në rrugë të gabuar. Duhet të dëgjohej edhe një herë me vëmendje Moisiu. Paraqitet Moira, perëndia greke e fatit dhe përfytyrimi i një moiré - efektit vezullues. Më pas, në thellësi shquhet një fotografi, një kujtim, një pamje tashmë e njohur, e cila fanitet ende e paqartë, e pasaktë, e mjegulluar. Një vezullim, një dridhje. Një gjë tejet morbide. Moisiu - një melodi ëndërrimtare. Ky burrë ishte aktor. Dhe ajo që ishte më veçorizuese për të, ishte zëri i tij. Ky emër me tingëllimin e një sirene homerike, që e merr njeriun peng, e ndjek, e bën të ndihet çuditshëm. Prosper Merimeja, autori i Carmenit, shprehej: "Historitë e çuditshme u ngajnë çdoherë vetëm atyre, emri i të cilëve shqiptohet me vështirësi". Kjo është një histori e mrekullueshme, magjike, prekëse, e dhimbshme, e njeriut, të cilit i ndodhi, jetonte në vitet '20, gëzoi famë botërore dhe në lidhje me të mund të rrëfehen shumë histori të vogla të veçanta: Se si ky njeri me këtë emër tingëllues, kur ishte shumë i vogël, dëshironte të fluturonte me një çarçaf drejt një ujdhesë të largët. Dhe se si pastaj gjatë luftës u bë pilot. Se si pushtoi një shtet me fjalë, gjuha e të cilit për të ishte e huaj. Se si ai kishte luajtur me vdekjen dhe i kishte mrekulluar ata që e shihnin. Sallat, e mbushura me nga dymijë shikues, i bënte për vete. Së bashku me të vdiqën edhe ata që e brohorisnin, ata që i bëri të qajnë me praninë e tij. E morën me vete në varr edhe fshehtësinë e tij. Në Gjermani, Aleksandër Moisiu ka qenë qysh nga viti 1910

e deri më 1930 ai aktori. Ka qenë një yll, i pari yll gjerman qysh në atë kohë, kur ende nuk kishte filma, ose atëherë kur filmi ende nuk merrej seriozisht dhe konsiderohej si një fanitje e përkohshme mode. Revista satirike "Simplicissimus" e karikaturonte në ballinë si zhongler - një zhongler me kafka. Hamleti i Shekspirin ishte një ndër rolet më të mëdhenj të Moisiut. Edhe në jetën e përditshme e quanin Princ, Princ Moisiu, për shkak të prejardhjes së tij fisnike, si pasardhës i disa pronarëve të mëdhenj tokash nga Ballkani. Por edhe ngaqë ai erdhi së andejmi si një princ përallash: me sytë e zinj, me zërin e ëmbël dhe me natyrën e tij të huaj, të sjellshme, pushtuese. Një herë, në Vjenë, në vitin 1926, princi Hamlet doli në skenë me xhakëtë, jelek të zi dhe me mantel shiu - një skandal i vërtetë! Shekspiri me veshje bashkëkohore. Një hutim i pamasë! Një kritik i zgjuar e qetësoi publikun me faktin se edhe piktorët e Cinquecentos e paraqisnin skenën me Krishtin në mjedisin e bashkëkohës. Në Berlin, njëzet vjet më herët, gjatë ndërrimit mes shekujve, regjisor i Maks Rainhard kishte sjellë një formë të re në teatër. Në pjesët e Shekspirin, të rinjtë luheshin nga të rinjtë; erotika dhe dashuria nuk ishin më vetëm fjalë; një teknikë e re ndriçimi i nxirrte fytyrat në pah. Një nga këta heronj të rinj ishte edhe Romeo, Aleksandër Moisiu. Dhe një ditë prej ditësh cilësohej si artist konservator, sepse prekte e zgjonte emocionet, besimin fëmijëror të publikut, dhe ngaqë ai nuk donte të bënte dallim mes atyre që quheshin e vjetër dhe e re. Për adhurueset nuk kishte fare rëndësi se ç'kishte Moisiu në trup, ky magjistar, dhe se çfarë zhvillimesh politiko-estetike ndodhnin në teatër. Gratë e adhuronin, e ndiqnin, i ofroheshin, i nënshtroheshin me pasion këtij zëri, siç shkruante një kolege. Edhe ai i ndiqte, i joshte, u bënte trysni. Kishte lidhje dashurie, dashuriçka, bashkëshorte dhe skandale. Shkrimtari vjenez Heinrich Novak paraqiti kërkesën për divorc pasi e shoqja, aktorja Cecilie Lvovsky, e kishte puthur me një zjarr "tejet të natyrshëm" kolegun e vet të skenës, Aleksandër Moisiun. Gjatë kësaj skene të puthjes, bashkëshorti qe nxehur atje në lozhë dhe kishte shkaktuar një skandal. Drama që luhej në skenë titullohej "Në

udhëtim". Gazetat kishin ç'të shkruanin lidhur me divorcin: "Rapsodia e Moisiut u dëshmuua për herë të parë me gjyq". Ky zë, ky shikim Moisiu ishte një erotoman i njohur, hero i tregimeve të ilustruara, një interpret virtuoz i vetvetes, me tiparet e një pop-ylli. Adhuruesit dëshironin ta shihnin Moisiun, ashtu siç dëgjohej Moxarti. Dhe një ditë prej ditësh ai u zhduk në asgjënë nga ku pat ardhur. Vdekja i solli menjëherë edhe famën pas vdekjes. Ungjilli i Gjonit tregon për fatin e Llazarit, të cilin Krishti e kthen pas katër ditësh nga varri në jetë. Ringjallja e Llazarit u takon rrefimeve shajnitëse të Shkrimit të Shenjtë. Duket sikur Krishti e kishte zbuluar fshehtësinë e tij para pasionit, me këtë veprim mrekullie, kur me trupin e vdekur të Llazarit provoi ringjalljen e Vet të mëvonshme. Historia e Moisiut i ngjan asaj të Llazarit. Mjeshtëria e tij ishte vdekja. Për çdo mbrëmje, çdo vit, në të gjitha skenat e mëdha. Një i shenjtë, por një i shenjtë botëror, pëllivan, një artist fenomenal, një martir i ndritshëm, i cili nuk rravonte një shenjë të Zotit, por qetësinë, tendosjen, shpërthimin e duartrokitjeve në sallat e mbushura plot. Një yll që shpërndante kartolinat me firmën e vet dhe që dukeshin si fotografi të shenjta. Hamleti në aureolë... Moisiu vdiq në moshën 55-vjeçare, që nuk është ndonjë moshë e shtyrë. Gjermania nuk ishte më atdheu i tij, ndoshta nuk ka qenë kurrë, dhe kështu ai nuk vdiq në mërgim dhe nuk mund të gjendej sërish së bashku me mërgimtarët dhe të dëbuarit, që u përmdoqën e u mohuan nga regjimi nazist. Vdiq në moshën mesatare, dhe çudi që dukej sikur karriera e tij nuk kish mbaruar, ndonëse kishte arritur në një fund. Ai kishte pasur edhe shumë plane të reja, por prapë vdekja nuk mori një njeri të pakryer. Ai kishte arritur gjithçka. Ishte i ndjekur nga fati, nuk i përkiste asnjë grupimi, qëndroi në lug të kohëve, ra nga bota, u fundos si një anije në thellësi të panjohura. Nuk gjendet një vit më i mirë për të vdekur. Pikërisht ai viti 1935 dukej sikur të ishte shterp nga ana historike. Çmendurinë e Hitlerit nuk e përjetoi më, shumë herët i ktheu shpinën Gjermanisë naziste, kur filluan fyerjet dhe kërcënimet edhe kundër tij, kundër një pjesëmarrësi të Luftës së Parë Botërore dhe mbajtësi të dekoratës Kryqi i Hekurt. Koha e vdekjes së tij fal hapësirë për persiatje. Po të kishte jetuar më gjatë, nga do të kishte shkuar? Për të shërbyer me armë ishte tashmë i moshuar. A do ta kishte mbajtur Zvicra, ku kishte një shtëpi? Cilën nënshtrësi do të kishte marrë: italiane, shqiptare, apo do të ishte

bërë amerikan? Si do t'i kishte qëndruar përballë aleatit të Hitlerit, Musolinit, me të cilin ishte njohur? Ajo që mbetet është heshtja, siç e parasheh Hamleti me frymën e tij të fundit. Heroi i grave, aktori më i madh gjerman mes dy Luftërave - është miti Moisiu. Mitet paraqesin formën më të bukur, më të saktë të harresës. Dhe çdo gjë e Moisiut bart diçka mitike. Se si ai në kohën kur u gjend në Burgtheater nuk dinte asnjë fjalë gjermanisht. Se në kaosin revolucionar të pas Luftës së Parë Botërore do të duhej të zgjidhej ministër komunist i Kulturës. Se Moisiu, si njeri hoteli, vdiq në hotelin vjenez "Grand" me fjalët e fundit që i nxori në jermi nga buzët e thara, në italisht: "Ah, che bella Venezia... che bella Venezia... che bella donnina", ndonëse parapëlqente hotelin pak më të mirë, "Imperial"-in. Ah, ta shohësh Venedikun dhe të vdesësh, të kalosh jetën nëpër hotele me zonjusha të bukura! Dhe se shoku i tij, aktori i njohur Albert Baserman ia dha Unazën Iffland me vete në varr, nderimi më i lartë gjerman për artin e aktrimit. Se ishte hebre me këtë emër, me këtë pamjen e huaj, apo rom, nga qeniet më të ulëta, më jogjermane... Të gjitha këto gjëra janë të shpikura - në një mënyrë të qëndrojnë mjaft afër së vërtetës dhe madje e prekin, ashtu siç e preku Aleksandër Moisiun jeta vetë. Dhe vetëm ai që ishte kaq i famshëm sa Moisiu, mund të harrohet kësajsoj. Kjo harresë arsyetohet sigurisht edhe me modën e artit. Por kjo nuk është më e rëndësishmja. Jetohet në një kohë kur përkujdesjes për këto histori të mrekullueshme nuk u jepet kohë dhe kur koha jeton që këto histori të rrëfehen dhe të shpiken të reat. "Bota e djeshme", siç e quante Stefan Cvajgu epokën që solli dhe mbajti një Moisi, me vite të tëra, dhjetëvjetësha me radhë. Nëse ka diçka për t'u shpjeguar, atëherë ky është durimi i kohës ndaj vetvetes. Jeta e Aleksandër Moisiut është një ndër përrallat më të bukura mbi artistët e shekullit XX. Përralla më e dashur e tij, të cilën ia lexonte me shumë kënaqësi vajzës së vet Betinës dhe të cilën e incizoi në një disk, ishte "Princesha në bizele" e Hans Christian Andersenit. Kështu edhe provonte princesha. Asaj iu shtrua një mal me dyshekë, dhe ajo atë natë nuk mbylli sy, sepse shtrati sipër bizeles ishte shumë i fortë. Ajo mund të shihte që ishte një princeshë, sepse e kishte mbushur bizelen me njëzet dyshekë dhe me jorganë puplash. Kaq e ndjeshme nuk mund të jetë askush, përveç një princeshë e njëmendtë. A nuk ndihemi edhe në kështu

me përrallën e princit Moisiu? Mes të gjitha atyre tregimeve të harruara, mes shtresave të harresës, të frymës së re, të avancardës së vjetër dhe të konvencioneve të reja, nën grumbullin me tradita fshihet diçka e vlefshme që, me butësi dhe këmbëngulje, e tërheq vëmendjen drejt vetes, dëshiron të vështrohet, si bizelja e vogël majë dyshekëve. Diçka na trazon prej së largu. Është si një ëndërr, shija dhe ritmi i së cilës, si dhe qenia e saj e paqartë, ndihen edhe në ditën e re. Një ëndërr, e cila të kujtohet gjithashtu për shkaqë të paqarta. Përpara e kemi një njeri, historinë e tij, vdekjen e tij, diçka që vërehet papritmas përmes mungesës së tij - për atë që ishte mbajtur fshehtë aq gjatë. Gjatë një udhëtimi me tren, Moisiu takon dy zonja që i njihen kalimthi. Biseda mori drejtimin politik. Aktori shpjegonte: "Kjo ndarja e punës deri në imtësi, që ka për qëllim prodhimtarinë gjithnjë e më të lartë, po bën që krejt njerëzimi i një shteti të shndërrohet në një makinë të vetme të jashtëzakonshme. Ajo më kryesorja lihet pas dore, njeriu, jeta". Ishte viti 1918 dhe po udhëtonin drejt Pragës. Ky shënim i çuditshëm gjendet në një arkiv në Vjenë, pa të dhëna për identitetin e zonjave dhe për mënyrën se si mbërriti kjo letër atje, se kur e paskan shkruar apo trilluar këtë kujtesë. Aleksandër Moisiu ishte zakonisht në shoqëri të zonjave gjatë udhëtimeve të veta në vagon dhe nuk mbetej vetëm në këmbime pikëpamjesh politike. Margarete Skoda, gruaja e aktorit të njohur vjenez Albin Skoda, udhëtonte si vajzë e re për shumë vite pas Moisiut të moshuar, duke u përfolur si adhuruese e flaktë, e cila refuzohej vazhdimisht nga idhulli i saj. Por ajo kurrë nuk u dorëzua. Derisa një natë, teksa rrotat e trenit rrokulliseshin nëpër binarë, Moisiu u dorëzua. Ajo ia ka përmendur këtë marrëdhënie të shkurtër një të njohur, kur ishte tashmë e shtyrë në moshë. Në rastin Moisiu burimet duken të dyshimta dhe marramendëse si rreth ndonjë sundimtari mesjetar. Shtrohet pyetja, për shembull: Çfarë dihet nga shekulli XX? I fam-shmi Moisi është më i panjohuri. Moisiu, fantazmë e luksit, e një të huaji, e një pasurie të humbur. Kush ndjek gjurmët e Moisiut, i hyn një aventure si të kërkimit të një thesari. Ky udhëtim është përpjës dhe plot me fshehtësi, por nuk është larg. (Fusnotat i ka hequr redaksia e gazetës)

(Përktheu nga gjermanishtja, Feride Xh. Berisha. Botuar në numrin e tretë të revistës për kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia")

E jashtëzakonshme

Robotët do të kryejnë 52 për qind të detyrave në vende të punës deri më 2025



Në një studim të ri është thënë se robotët do të kryejnë më shumë se "gjysmën e detyrave aktuale në vendet e

punës" deri më 2025. Në një raport të Forumit Ekonomik Botëror, të prezantuar më 17 shtator, vlerësohet se 52 për

qind e të gjitha detyrave, pothuajse dyfishi i normës aktuale do të përfundohen nga robotët.

FOTO E DITES



Fëmijët përdorin një gomë për të kaluar një rrugë të përmytur në Filipine. /AFP/

E rrallë

Zbulohet peshku gjel në 7.5 km thellësi në Paqësor

Shkencëtarët kanë zbuluar tri lloje të reja të peshqve "hardcore" që jetojnë në një nga pjesët më të thella të oqeanit dhe që janë krijesa pa shtyllë kurrizore, të përshtatura në mënyrë të përkryer me kushtet që do ta vrisnin menjëherë jetën në tokë. Trupi i këtij lloji të



peshkut është si gjel likuid dhe i gjen me ngjyrë të kuqe dhe blu. Këto krijesa janë kanë gjatësi 20 deri në 25 cm.

BARSOLETA E DITËS



Burri: Zemër, a linde?
Gruaja: Po.
Burri: Vajzë apo djalë?
Gruaja: Djalë.
Burri: Kujt po i ngjan?
Gruaja: Njërit në punë që s'e njih ti.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"HOTEL TRANSYLVANIA; Summer Vacation" 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 37 min

Rolet: Adam Sandler, Selena Gomez, Andy Samberg, Kevin James, David Spade, Steve Buscemi, Molly Shannon, Mel Brooks, etj.

Regjia: Genndy Tartakovsky



Në ora 18:00

"THE DARKEST MINDS"

Fantastiko-Shkencor/Triller; 1 orë 45 min

Rolet: Bradley Whitford, Amandla Stenberg, Mandy Moore, Gwendoline Christie, etj.

Regjia: Jennifer Yuh Nelson



Në ora 20:00 dhe 22:00

"THE PREDATOR" 3D,

Aksion/Aventure/Horror; 1 ore 47 min

Rolet: Boyd Holbrook, Trevante Rhodes, Jacob Tremblay, Keegan-Michael Key, Olivia Munn, Sterling K. Brown, Alfie Allen, Thomas Jane, Augusto Aguilara, Jake Busey, etj.

Regjia: Shane Black



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Nëse keni parë që persona të caktuar nuk kanë shumë simpati për ju, sot duhet të bëni të mundur që ky opinion të ndryshojë.</p>	 <p>DEMI Gjeni kurajën dhe hiqni dorë nga një situatë që nuk po e kontrolloni më. Megjithëse do të thotë shumë për ju, duhet të merrni vendim.</p>	 <p>BINJAKËT Nuk keni pse të mërzhiteni nëse gjërat kanë marrë një rrjedhë të caktuar. Keni qenë ju vetë që jeni bërë shkak për këtë rezultat.</p>	 <p>GAFORRJA Sot do ta keni të vështirë të merrni një vendim. E dini që shumë nga personat që keni pranë do të preken nga kjo gjë.</p>	 <p>LUANI Nëse e dini që një kolegu juaj merret shumë me llafe, nuk keni pse ia konfirmoni një projekt tuajin. Do ta marrë të gjithë meritën.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Në fushën profesionale sapo ndiheni shumë mirë sot. Për këtë arsye keni dyshime të forta të mbyllni marrëveshje dhe kontrata me persona të tjerë.</p>
 <p>PESHORJA Duhet të eliminoni çdo formë stresi në ditët në vijim. Nëse ende nuk keni vendosur për të ndërmarrë një veprim, sot është dita.</p>	 <p>AKREPI Sot do të jetë një ditë relaksimi që keni dëshirë ta kaloni sa më larg ambientit të punës. Një piknik ose një shëtitje në plazh janë ato që po kërkoni.</p>	 <p>SHIGJETARI Nëse sot nuk doni të jeni shumë i zënë me punë, bëni mirë të mos lini takime ose orare të reja. Mund të keni përplasje takimesh.</p>	 <p>BRICJAPI Sot do t'ju plotësohet çdo kërkesë. Duhet të jeni mirënjohës ndaj një eprori ose të afërmi tuaj që ju kanë kaq përzemërt.</p>	 <p>UJORI Sot duhet të arrini një qëllim të caktuar edhe nëse do t'ju duhet të bashkëpunoni me armiq të tuaj. Siç thuhet, çdo qëllim justifikon mjetin.</p>	 <p>PESHQIT Është shumë e thjeshtë t'i shtyni gjithmonë gjërat për nesër. Por sot, nëse nuk doni të impenjoheni me një person, duhet t'ia thoni.</p>

Cristiano Ronaldo hap restorant: Jam shumë i emocionuar



Restoranti i ri "Zela" i Cristiano Ronaldos do të inaugurohet këtë muaj në Londër. Sulmuesi portugez thotë se është shumë i emocionuar për këtë aventurë të re. "Jam shumë entuziast që jam pjesë e kësaj skuadre dhe që po hap në Londër restorantin tim


të preferuar", shkruan ai në "Instagram". Restoranti është një bashkim i ushqimit japonez dhe mesdhetar dhe është në pronësi të grupit të "Mikpritjes Mabel". Përveç Cristiano Ronaldos, aksionar është edhe tenisti Rafael Nadal e këngëtari Enrique Iglesias.

Jay Z është mbreti i pasanikëve të repit



Jay-Z udhëheq renditjen e këngëtarëve rep që kanë fituar më shumë në vitin 2018. Lajmi është bërë me dije nga revista "Forbes", e cila ka publikuar renditjen e saj vjetore. Me 76.5 milionë dollarë, këngëtari amerikan i shikon të gjithë nga lartësia falë të ardhurave të arritura nga puna e tij

e fundit, "4:44" dhe nga turi botëror së bashku me bashkëshorten e tij, këngëtarën Beyoncé. Në vend të dytë, renditet Puff Daddy, me 64 milionë dollarë të ardhura, të arritura falë investimeve në industrinë e pijeve alkooolike. I fundit renditet Kendrick Lamar, me 58 milionë dollarë.



Khloe dhe Tristan, të lumtur pranë njëri-tjetrit

Khloe Kardashian dhe Tristan Thompson po kalojnë ca kohë së bashku. 34-vjeçarja dhe basketbollisti 27-vjeçar u panë të dielën në Calabasas të Kalifornisë. Ata ishin duke

shkuar për të parë White Boy Rick dhe dukeshin shumë të lumtur pranë njëri-tjetrit. Të dy ishin veshur me rroba sportive dhe atlete Nike. Çifti ka një vajzë me emrin True.

Pitt dhe DiCaprio vazhdojnë xhirimet e filmit të ri



Brad Pitt dhe Leonardo DiCaprio i janë kthyer punës. Aktorët u panë duke xhiruar skena të reja të filmit 'Once Upon a

Time In Hollywood', të dielën në Los Angeles. Të dy ishin duke punuar shumë bashkë me grupin e tyre që marrin pjesë në film.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE GALATASARAY - LOKOMOTIV MOSCOW **1** SCHALKE 04 - FC PORTO **GG** LIVERPOOL - PSG **1**

Drita sheh shpëtimin te Shpëtim Duro

Shpëtim Duro është emëruar trajner i skuadrës së Dritës. Drejtuesit e klubit shpresojnë se ai do ta rikthejë shkëlqimin e skuadrës që kishte dikur. 58-vjeçari nga Tirana ka drejtuar shumë klube në Shqipëri. Ka drejtuar edhe Shkëndijën e Tetovës në Maqedoni



skuadrën e Prishtinës, e cila po kalon nëpër një krizë rezultatesh. 58-vjeçari Shpëtim Duro ka karrierë të pasur si trajner. Ai ka punuar ndihmëstrajner në Kombëtaren e Shqipërisë, kurse më pas ka drejtuar këto skuadra: Partizanin, Tiranën, Besa Kavajën, Skënderbeu Korçë,

Vllazninë Shkodër, Shkëndijën dhe Flamurtari Vlorë. Pas krizës në skuadrën e Dritës është larguar edhe drejtori Fisnik Kerçeli, kurse klubi e ka falënderuar për punën dhe angazhimin e madh që ka bërë në rrugëtimin drejt sukseseve në rrafshin vendor dhe ndërkombëtar. "Futbolli është

sport i paparashikueshëm. Si i tillë, na dhuroi emocione të cilat vështirë përshkruhen. Ju ishit një nga njerëzit që kontribuan shumë që ëndrra e dashamirëve të klubit të realizohet. Për punën, angazhimin profesional, sukseset dhe sakrificën për klub do të mbahesh mend gjatë. Jemi shumë krenarë për kohën që bashkëpunuam. Të urojmë shëndet dhe shumë suksese në jetë dhe karrierë!", thuhet në falënderimin e klubit të Dritës.

Një tjetër risi në skuadrën e Dritës është se të hënën tifozët "Intelektualët" i kanë vizituar futbollistët gjatë seancës stërvitore dhe kanë ofruar mbështetjen e tyre edhe përkundër humbjeve të shumta në këtë edicion, por ata kanë kërkuar nga futbollistët ta japin maksimumin në ndeshjet e radhës për të arritur te rezultatet pozitive.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Risitë në skuadrën kampione të Kosovës në futboll, Dritën e Gjilanit, nuk kanë të ndalur. Trajneri Bekim Isufi ditë më parë është larguar nga skuadra për shkak të rezultateve të dobëta në këtë kampionat, kurse drejtuesit e kësaj skuadre e kanë zëvendësuar Isufin me trajnerin e mirënjohur nga Shqipëria, Shpëtim Duro. "Mirë se vini, profesor! Nga sot në krye të shtabit teknik në skuadrën tonë do të jetë trajneri i mirënjohur Shpëtim Duro. Duro është trajner

i dëshmuar dhe shpresojmë që së bashku do t'i arrijmë objektivat që kemi. Na prihtë e mbara!", thuhet në njoftimin e skuadrës nga Gjilani.

Misioni i trajnerit Duro nuk do të jetë aspak i lehtë, pasi Drita synim ka mbrojtjen e titullit dhe fillimi në këtë kampionat ka qenë tmerresisht i dobët për të, pasi prej pesë ndeshjeve të luajtura ka regjistruar vetëm një fitore dhe katër humbje. Kjo skuadër është e parafundit në renditjen tabelore në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Ndeshja debutuese e trajnerit Duro do të jetë mjaftë e vështirë, pasi Drita e pret

Liga e Kampionëve rikthehet me dy superpërballje



LIVERPOOL, 17 SHTATOR - Pas 115 ditësh nga triumfi i fundit, i tretë radhazi për Real Madridin, rikthehet magjia e Ligës së Kampionëve, me rrugëtimin në fazën e grupeve. Ashtu si gjithmonë, 32 skuadra do të sfidohen për ta ngritur trofeun më të rëndësishëm të futbollit evropian. Dy të parat e tetë grupeve do të avancojnë në fazën e eliminimit të drejtpërdrejtë, me përballje vajtje-ardhje për 1/8-tat, çerekfinalët dhe gjysmëfinalët,

teksa finalja e madhe do të vendoset në "Estadio Wanda Metropolitano" të Madridit, shtëpia e Atletico.

Por, cila është risia e edicionit 2018-2019?

Për të parën herë ndeshjet e grupeve do të ndahen në orare të ndryshme me të paktën dy ndeshje në orën 18:55. Do të jetë radha edhe e tri skuadrave debutuese të zbresin në skenën e Ligës së Kampionëve: Young Boys, Hoffenheim dhe Crvena

GRUPI A
21:00 Club Brugge - Borussia Dortmund
21:00 Monaco - Atletico Madrid
GRUPI B
18:55 Barcelona - PSV Eindhoven
18:55 Inter - Tottenham Hotspur
GRUPI C
21:00 Crvena Zvezda - Napoli
21:00 Liverpool - Paris Saint Germain
GRUPI D
21:00 Galatasaray - Lokomotiv M.
21:00 Schalke - Porto

Zvezda, që tashmë çojnë në 140 numrin e skuadrave pjesëmarrëse në fazën e grupeve në historinë e kompeticionit. Sonte zhvillohen dy superndeshje. Në Angli Liverpooli e pret skuadrën e Paris Saint Germainit nga ora 21:00, ndërsa në orën 18:55 Interi e pret skuadrën e Tottenham Hotspurit.

Ademi, më 27 shtator, takim me Infantinon

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino, e ka ftuar kryetarin e Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademin, për vizitë në selinë e FIFA-s në Cyrih më 27 shtator. Në ftesën e dërguar nga Bjorn Vassallo, drejtor i Federatave Anëtare të Evropës, thuhet se në kuadër të angazhimit të FIFA-s dhe bashkëpunimit me shoqatat anëtare të saj, presidenti Infantino dëshiron të ketë një takim zyrtar me presidentin e ri të FFK-së, Agim Ademi, kryesisht për ta diskutuar

strategjinë e futbollit në Kosovë dhe prioritetet e FIFA-s për të ardhmen. FFK-ja nëpërmjet një njoftimi për medie ka bërë me dije se bashkë me presidentin Ademi në këtë takim do të jetë edhe sekretari i përgjithshëm, Eroll Salihu. "Ky takim dhe mbështetja e vazhdueshme që ka dhënë FIFA për Kosovën dëshmon edhe një herë afërsinë që ka krijuar Federata e Futbollit e Kosovës me institucionin botëror të futbollit, përkatësisht me presidentin Infantino", thuhet në njoftimin e FFK-së.



Casillasi, 20 sezone radhazi duke luajtur në Ligën e Kampionëve

PORTO, 17 SHTATOR - Portieri i Portos, Iker Casillas, do ta nisë të martën sezonin e tij të 20-të radhazi në Ligën e Kampionëve, duke thyer rekordin e uellsianit Ryan Giggs, i cili kishte arritur të

duronte 19 sezone radhazi në kompeticionin më të rëndësishëm për klube në botë. Spanjollli nisi të luajë në Ligën e Kampionëve më 5 shtator 1999, me Real Madridin, në një ndesh-

je kundër Olympiakosit, kur ishte vetëm 18 vjeç. Me "Los Blancos" luajti 16 sezone radhazi, duke qenë pjesëmarrës në 152 ndeshje (90 fitore, 29 barazime dhe 33 humbje). Gjithashtu, fitoi tri Liga

të Kampionëve (1999-2000, 2001-2002 dhe 2013-2014). Me Porton ka luajtur në tre edicione të Ligës së Kampionëve, ndërsa nga sot (e martë) do ta nisë sezonin e katërt.



Salah: Mund ta fitojmë Ligën e Kampionëve dhe Premierë Ligën

LIVERPOOL, 17 SHTATOR - Liverpooli po kalon një çast fantastik me nisjen e këtij sezoni, ku dhe ndan vendin e parë me skuadrën e Chelset, me pikë të plota pas pesë javëve të luajtura. Paraqitjet mjaft të mira kanë dhënë mjaft besim në kampin e kuq se ky

mund të jetë dhe viti i tyre. Një ndër protagonistët kryesorë të vitit të shkuar, Mohamed Salah, ka folur për pritshmëritë e tij për sa i përket sezonit aktual. Egjiptiani deklaroi se e sheh ekipin mjaft të kompletuar dhe shumë në formë. Sipas sulmue-

sit, çdo gjë është e mundur dhe mendon se Liverpooli ka mundësi të arrijë përsëri në finalen e Ligës së Kampionëve, pse jo dhe ta fitojë atë. Gjithashtu, dhe për kampionatin Salah tha se "The Reds" do të jenë kampionë këtë vit.

"Sigurisht se mund të arrijmë në finale përsëri, madje këtë herë për ta fituar. Jam i sigurt se mund të fitojmë Ligën e Kampionëve dhe Premierë Ligën. Nuk dua ta vendos askënd në presion, por dua të them se çdo gjë është e mundur", ka thënë Salah.



Filloi kursi i trajnerëve për Licencën B të UEFA-s



PRISHTINË, 17 SHTATOR - Federata e Futbollit e Kosovës ka nisur të hënën me kursin e trajnerëve për Licencën B të UEFA-s, që mbahet për herë të parë nën ombrellën e saj. Në hapje të këtij kursi morën pjesë anëtarë të KE të FFK-së, Bakir Burri, sekretari i përgjithshëm i FFK-së, Eroll Salihu, Anna Stege nga ambasada gjermane, Horst Kriete ekspert nga federata gjermane, drejtori teknik i FFK-së, Mihael Nees dhe Sanije Krasniqi, menaxhere e FFK-së për Grassroots.

Në fazën e parë dhjetëditore pjesëmarrësit do t'i ndjekin ligjëratat dhe punën praktike me ekspertë të këtij profesioni, derisa në nëntor do të mbahet edhe faza e dytë ku trajnerët kandidatë do t'u nënshtrohen edhe provimeve. "Kjo

ditë është shumë e veçantë, pasi është një rrugë e gjatë që kemi kaluar për të arritur deri këtu dhe pa dyshim është një prej hapave më të rëndësishëm për sistemin e edukimit dhe licencimit, sepse ju jeni gjenerata e parë që do ta vijoni kursin për Licencën B UEFA. Do të njiheni gjithmonë si gjenerata e parë që e ka marrë Licencën B nga FFK-ja. Shpresoj dhe uroj të jetë një kurs sa më i suksesshëm. Duke e ditur se e keni një bazë të fortë të njohurive nga kursi i Licencës C jam i bindur se do të kaloni me sukses edhe këtë kurs", ka deklaruar Salihu. Ligjërues i këtij kursi do të jetë edhe përfaqësuesi i UEFA-s, Dany Ryser, i cili njëherësh edhe do ta vëzhgojë punën që do të bëhet në këtë kurs.

Hamiltoni: Suksesi në Singapor, më i rëndësishmi i këtij sezoni



LONDËR, 17 SHTATOR - "Suksesi në garën e Singaporit mund të jetë më i rëndësishmi në këtë sezon, pasi u arrit në një pistë të vështirë për Mercedesin dhe në një moment delikat të sezonit. Ndaj e konsideroj këtë triumf si një hap të rëndësishëm drejt titullit", u shpreh Lewis Hamiltoni që tashmë ka 40 pikë avantazh karshi Sebastian Vettelit në renditjen e përgjithshme të Botërorit të Formula 1. Duke folur për garën, ai shtoi: "Ishte shumë e vështirë, por më ndihmuan edhe tifozët që më mbështesnin në çdo moment. I rëndësishëm ishte starti i garës, ku ruajta kreun,

por edhe më pas gara pati momente të vështira, pasi parakalimet këtu janë të vështira. Më ngjante sikur gara nuk do të përfundonte kurrë", ka thënë piloti britanik. "Këtë herë duellova në disa çaste me Verstappen, që kërkoi të përfitonte nga parakalimet, por ia dola ta ruaja qetësinë dhe të krijoja një diferencë sigurie në garë. Edhe Ferrari ishte në formë dhe deri në fund shpresoi, por ne ishim më superiorë në pistë dhe e merituam fitoren. 40 pikët avantazh janë të konsiderueshme, por Botërori ka ende gjashtë gara deri në fund", ka deklaruar Hamiltoni.

SHKURT

Strakosha: Rëndësi ka vetëm fitorja

Thomas Strakosha ka qenë vendimtar në fitoren e Lazios në udhëtim te Empoli 0-1. Portieri shqiptar ka bërë disa pritje vendimtare, ku njëra prej tyre ishte në sekondat e fundit ndaj Caputos. Pas ndeshjes Strakosha ka folur për fitoren e madhe në udhëtim. "Nuk e prisja atë goditje. Kur e pashë topin në atë moment kisha frikë se do të shënonin. E rëndësishme është që e pritja, dhe jemi të kënaqur me rezultatin që arritëm si skuadër. Rëndësi në fund ka vetëm fitorja", ka thënë Strakosha. "Kemi parë që Empoli ka ekip të mirë. Tregoi edhe sot. Përgëzime edhe për të. Duhet ta nisim nga këtu, pasi ende na presin ndeshje të vështira. Dy takimet e para ishin të vështira, por mësuam nga ato humbje, dhe tani morëm dy fitore. Na mbetet ta arrijmë edhe formën e mirë fizike. Jemi në rrugën e duhur", ka deklaruar Strakosha.

Zidane apo Lopetegui, s'ka përgjigjeje nga Bale

Pas largimit të Zinedine Zidane nga "Santiago Bernabeu", si zëvendësues i tij erdhi Julen Lopetegui. Që nga ardhja e spanjollit Gareth Bale është rikthyer në formacion dhe është kthyer në lojtarin kryesor të Real Madridit. Mirëpo, i pyetur nga gazetarët se cilin trajner preferon më shumë, uellsiani ka hezituuar të përgjigjet. "Nuk dua të përgjigjem nëse Lopetegui ose Zidane është më i mirë", është përgjigjur shkurt Bale. 29-vjeçari ka rikthyer shkëlqimin e tij dhe më në fund duket i lumtur në Madrid.

Wade rikthehet në Miami

Ylli i NBA-së, Dwyane Wade, ka bërë të ditur se do të rikthehet për një sezon përmbysllës te Miami Heat. Wade kaloi gati tërë karrierën me Heat dhe ishte në dilemë nëse do të vazhdonte edhe për një sezon. Dilema e tij sigurisht nuk qëndronte për skuadrën, por ai nuk ishte i bindur nëse do të luante edhe për një vit. 36-vjeçari, i cili është tri herë kampion i NBA-së me Miamin, ka thënë se ky ishte vendimi më i vështirë për të.

Kloppi: PSG-ja është favorite në Ligën e Kampionëve

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, e ka cilësuar kundërshtarin e ardhshëm Paris Saint-Germainin si njërin prej favoriteve për ta fituar Ligën e Kampionëve këtë sezon. Liverpooli është nikoqir i PSG-së në ndeshjen hapëse të sezonit të ri të Ligës së Kampionëve në ndeshjen e cila zhvillohet sonte (e martë) nga ora 21:00. "Ata janë një nga favoritët e kësaj gare. Jemi të vetëdijshëm për cilësinë e tyre. Luajmë në Anfield dhe kjo mund të jetë një përparësi për ne. Më pëlqejnë këto sfida, por vetëm sepse kam një skuadër vërtet të mirë. Nëse nuk do të isha menaxher, do të shikoja patjetër këtë ndeshje", ka thënë Klopp.

Tucheli: Bayernin e refuzova për ketë arsye

Thomas Tuchel ka zbuluar se Bayern Munichu kishte tentuar ta emëronte atë trajner pak para se ai t'i bashkohej Paris Saint-Germainit në fillim të këtij viti. Tuchel thotë se Bayernin u vonua, pasi ai tashmë e kishte ndarë mendjen për t'u larguar nga kampionati gjerman. Ish-trajneri i Borussia Dortmundit pushoi një vit pasi u largua nga "Signal Iduna Park" dhe iu rikthye futbollit në maj të 2018-s kur nënshkroi kontratë dyvjeçare me PSG-në. 45-vjeçari ka vendosur rekord të ri të klubit parisien pasi i ka fituar të gjitha gjashtë ndeshjet e para në Ligën 1. Tuchel ka thënë për L'Equipe se oferta e Bayern Munichut kishte ardhur tepër vonë. "Me Bayernin kam pasur vetëm kontakte. Oferta e tij erdhi shumë vonë, sepse unë tashmë kisha vendosur t'i bashkohem PSG-së. Zgjedhja ime pas largimit nga Dortmundi ishte shumë e qartë, ishte diçka që vinte thellë nga brenda. Nëse jam me fat të kem një përvojë jashtë vendit, më duhet të provoj. Ishte e qartë për mua, familjen dhe stafin tim. Parisi është i veçantë dhe ishte befasi e bukur", ka thënë Tuchel.



Ifrastuktura Hekurudhave të Kosovës "INFRAKOS" Sh.A
shpall:

K O N K U R S

POZITA: Zyrtar për planifikim dhe zhvillim – Fusha e ndërtimitarisë

NJËSIA: Zyra për planifikim dhe zhvillim

KONTRATA: Me kohë të pacaktuar

I RAPORTON: Menaxheres së zyrës për planifikim dhe zhvillim

PËRGJEGJËSI MBIKQYRËSE: Jo

Lokacioni: Fushë Kosovë

DETYRAT DHE PERGJEGJSIT KRYESORE:

- Harton , përpilon dhe jep sugjerime për çështjet e ndërtimitarisë në kompani.
- Merr pjese në hartimin e projekteve zhvillimore për tërë linjat hekurudhore ekzistuese dhe për linja te reja.
- Në bashkëpunim me bashkëpunëtorët profesional, planifikon, specifikon zgjerimet dhe nevojat për instalime te reja ne rrjetin hekurudhorë.
- Bashkëpunon me departamentet/sectorë tjerë, brenda hekurudhës, me qëllim të mbledhjes së të dhënave për projekte të reja.
- Përcjell dhe hulumton zhvillimet e reja në teknologjinë e sistemeve hekurudhore dhe propozon për aplikimin e tyre.
- Synon implementimin e projekteve më të rëndësishme që ndikojnë drejtpërdrejt në performancën e sistemit të infrastrukturës hekurudhore në përgjithësi.
- Ndjek hapin bashkëkohor në lëmin e planifikimit dhe zhvillimit të sistemeve hekurudhore.
- Merr pjese ne hartimin e projekteve për binarë industrial, bënë llogarinë e punëve për ekzekutim dhe i mbanë të dhënat e binarëve industrial.
- Harton plane konform rregulloreve ekzistuese dhe standardeve ndërkombëtare me qëllim rritjen e sigurisë ne rrjetin hekurudhore.
- Merr pjese ne hartimin e projekteve për përmirësim te gjendjes se vendkalimeve.
- Analizon gjendjen e vendkalimeve dhe propozon plane për përmirësimin e gjendjes se tyre.
- Përmes projekteve konkret propozon modernizimin e linjave ekzistuese hekurudhore sipas strategjive zhvillimore, arsyeshmërisë ekonomike dhe zhvillimin e linjave hekurudhore për plotësimin e kriterëve teknike të interoperabilitetit.
- Kryen detyra tjera te përcaktuar nga mbikëqyrësi.

KUSHTET, AFITESITE DHE NJOHURIT E KERKUARA;

- Ing i dip i Ndërtimitarisë
- 3 vjet përvojë pune në lëmin e Hekurudhës apo të ngjashme
- Aftësi të mira organizative dhe planifikuese
- Aftësi të mira të bashkëpunimit
- Aftësi të mira që të punoj nënë presion dhe aftësi që të kryej punët brenda afatit.
- Njohës i mirë i gjuhës Shqipe, serbe dhe angleze
- Njohja e punës me kompjuter

PROCEDURA E APLIKIMIT:

Aplikacioni dhe konkursi mund të merren në Web faqen e Infracos Sh.A. Aplikacioni së bashku me dëshmitë tjera duhet të dorëzohen në shkrimore në ndërtesën e drejtorisë së Infracos-it, në adresen Sheshi i Lirisë , pn, në Fushë Kosovë. Dokumentet duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur në të cilën duhet të shkruhet pozita për të cilën aplikon. Data e fundit për aplikim është : **01/10/2018 ora 14:00**. Dokumentacioni që mbërrin pas këtij afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm në kopje pasi të njëjtat nuk ju kthehen.

Do të testohen të gjithë kandidatët të cilët i kanë plotësuar kushtet e konkursit. Për informata kontaktoni në numrin e tel. 038 550 550 237.

Njoftimi për shprehje të interesit

Shkolla/komuna:SHFMU "Jusuf Gërvalla" Biqec, Kaçanik

Data:19.09.2018

Emri i kontratës:Plani individual i arsimit PIA

Numri i kontratës:ESIP/C1.3/026-ESIP/SDG/026-CS/1.5

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP)*, dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe SHFMU "Jusuf Gërvalla" Biqec, Kaçanik. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

Trajnim i mësimdhënësve në programin:

Plani individual i arsimit PIA

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën: SHFMU "Jusuf Gërvalla" Biqec, Kaçanik ,më së largu deri më :27.09.2018.

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Kemal Dullovi - Drejtor

Tel. 044/235-659

kemaldullovi60@gmail.com

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: Shfmu "DITURIA"

Komuna: Kaçanik

Data: **14 Shtator 2018**

Emri i kontratës: Furnizim me Llaptopa

Numri i kontratës: ESIP/C1.3/148-ESIP/SDG/148-G/1.1

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP)*, dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles "Dituria" fshati Ivajë komuna Kçanik. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme: :

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

Furnizim i shkollës me 7 Llaptopa

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën Adresa e Shkolles:

Shfmu "DITURIA" Ivajë Komuna Kaçanik më së largu deri më 24 Shtator 2018

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues:

Nexhadi Luta

Telefoni: 044 224 878

E-maili: nexhadiluta@hotmail.com



Republika e Kosovës
